



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 37 regjistër (JR)  
Datë 04.12.2018

Nr. 15 i vendimit  
Datë 17.07.2019

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 17.07.2019, ditën e mërkurë, në orën 19:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka, prokuror, drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKT:** Shqyrtimi i vendimit nr. 55, datë 31.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 55, datë 31.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur detyrën prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ai ka aplikuar për të qenë anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe për këtë shkak nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017.
2. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
  - ii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - iii. ka kryer fshehje të pasurisë;
  - iv. ka kryer deklarim të rremë;
  - v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
3. Me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017, trupi gjykues i Komisionit, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Dritan Rreshka. Më datë 06.07.2018, trupi gjykues i Komisionit vendosi të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm mbi kriterin e kontrollit të pasurisë dhe të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet paraprake të këtij hetimi.
4. Më datë 25.07.2018, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të njihet edhe me rezultatet e hetimit për dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe atë profesional. Trupi gjykues i Komisionit nuk e ka pranuar kërkesën duke argumentuar se provat e administruara nga ana e Komisionit për kriterin e pasurisë arritën nivelin e provueshmërisë për të kaluar barrën e provës dhe vendimi mund të merret bazuar vetëm në një kriter, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili specifikon: *Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave*, si dhe sipas vendimit nr. 3, datë 17.07.2018 të Kolegjit të Apelit, pika 16 e seksionit III të këtij vendimi.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 55, datë 31.07.2018, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Rreshka, me funksion Prokuror/Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 179/b, nenet D, Ç dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

7. Vendimi nr. 55, datë 31.07.2018, është marrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Dritan Rreshka, bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të kontrollit të pasurisë, pasi nga Komisioni është konkluduar:

“1. Në lidhje me pasurinë nr. 1, katin përdhes dhe të dytë të një shtëpie private, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, Komisioni arrin në përfundimin se:

*i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm:*

1) burimin e ligjshëm të kësaj pasurie të legalizuar më datë 20.02.2012, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në mars 2012;

2) nuk provoi burimin e të ardhurave nga emigracioni dhe qiraja e katit përdhes të kësaj prone; dhe

3) nuk provoi me dokumentacion ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

*ii. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë:*

1) fillimin e punimeve të ndërtimit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003;

2) dy kate ndërtim (i tretë dhe i katërt) në deklarin vjetor të vitit 2012;

3) legalizimin e ndërtimit të godinës 5-katëshe në deklarin e vitit 2012;

4) dhurimin e apartamentit me sip. 166,2 m<sup>2</sup> vëllait të tij, z. B. Rr.

*iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për këtë aset, për shkak se:*

1) ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin;

2) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar koston e ndërtimit, shfrytëzimit dhe mobilimit të kësaj pasurie respektivisht në vitet 2003-2004 nga emigracioni në Greqi dhe 2009 nga qiraja e katit përdhes;

3) ka kryer fshehje të kësaj pasurie në deklarinet vjetore;

4) ka kryer deklarin të rremë të vlerës së ndërtimit të kësaj godine;

5) ka mospërputhje të deklarimeve midis deklaratës vjetore 2009 dhe deklaratës “vetting” në lidhje me kontributin financiar që ka shërbyer për shtesën e katit të tretë dhe të katërt;

6) si dhe ka mospërputhje në lidhje me datën e fillimit të punimeve të kësaj godine.

2. Për gjendjen e llogarisë rrjedhëse pranë BKT-së në vlerë 1.990.000 lekë, dhe më konkretisht: (1) kontratën e blerjes dhe të shitjes së apartamentit me sip. 97,8 m<sup>2</sup>, {\*\*\*} Tiranë, dhe (2) kredinë me kushte lehtësuese të përfituar nga BKT-ja në vlerë 5.000.000 lekë, bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, si dhe ligjin e zbatueshëm, në lidhje me burimet e krijimit të kësaj llogarie rrjedhëse, Komisioni arrin në përfundimin se:

*i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë në lidhje me shitësin e apartamentit me sip. 97,8 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Tiranë, dhe ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për likuidimin e shumës 1.250.000 Lekë, në dhjetor të vitit 2011, për blerjen e këtij apartamenti, sipas kontratës së shitblerjes së këtij apartamenti (kontratë e cila ka shërbyer si burim për krijimin e gjendjes së llogarisë).*

*ii. Subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi lehtësuese në shumën 5.000.000 lekë, në mënyrë të padrejtë, duke mos qenë në rrethin e personave përfitues, referuar VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007.*

*iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të rremë dhe fiktiv në lidhje me faktin se nuk posedonte asnjë pronë të paluajtshme në vendin e ushtrimit të detyrës, Tiranë, si dhe nuk dispononte pasuri me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim, referuar kontratës së kredisë me BKT-në (kredia që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 97,8 m<sup>2</sup>, në {\*\*\*}, Tiranë, i cili është shitur në vitin 2016).*

3. Në lidhje me blerjen e obligacioneve në tregun primar pranë BKT-së, datë 21.10.2015 dhe 17.2.2016, me vlerë 7900.000 lekë, bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, si dhe në ligjin e zbatueshëm, në lidhje me burimet e blerjes së këtyre obligacioneve, Komisioni arrin në përfundimin se:

*i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga qiraja e katit përdhes, për shkak se nuk kishte paguar detyrimet tatimore të të ardhurave nga qiraja për vitet 2009, 2010 dhe 2012, respektivisht për shumën prej 2.000.000 lekësh.*

*ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë llogari për shkak se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e një pjese të obligacioneve në shumën 2.000.000 lekë.*

4. Në lidhje me pronësinë mbi aksionet e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, të personave të tjerë të lidhur, z. S.Rr. dhe znj. A.Rr.; bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku, si dhe në ligjin e zbatueshëm, në lidhje me mjaftueshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e vlerës prej 32.951.037 lekësh dhënë borxh shoqërisë, Komisioni arrin në përfundimin se:

*i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të shumës prej 32.951.037 lekësh, që personat e lidhur, z. S.Rr. dhe znj. A.Rr., i kanë dhënë borxh shoqërisë “{\*\*\*}” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.*

5. Për depozitën në shumën prej 3885914 lekësh, në emër të shtetasës Xh.Rr., nëna e subjektit të rivlerësimit/person tjetër i lidhur, pranë “Raiffeisen Bank”, Komisioni arrin në përfundimin se:

*i. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të shumës prej 3885914 lekësh, vendosur në depozitë nga ana e personit tjetër të lidhur, nënës së subjektit, znj. Xh.Rr., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

8. Subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka, më datë 12.11.2018 ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 55, datë 31.07.2018, të Komisionit, ankim i cili u pranua nga trupi gjykues i Komisionit, me vendimin nr. 4, datë 15.11.2018.

9. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka kundër vendimit nr. 55, datë 31.07.2018, të Komisionit, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

**9.1** Për pasurinë banesë 5 kate në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, lidhur me kohën e ndërtimit, burimin e të ardhurave dhe me pamjaftueshmërinë e të ardhurave për ndërtimin e saj, subjekti i rivlerësimit pretendon: *nuk ka kryer deklaram të rremë lidhur me kohën e ndërtimit të banesës; vlera e ndërtimit të banesës 5 kate në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë është më e vogël se ajo e përcaktuar në vendim nga Komisioni, pasi është ndërtuar në kushtet e informalitetit dhe me kontribut të familjarëve të tij; burimi i të ardhurave të përdorura për ndërtimin e kësaj banese ka qenë me burim të ligjshëm nga puna në emigracion e tij dhe e familjes, nga puna si dhe nga kredia e marrë vitin 2004 prej tij në NBG Bank, me vlerë 18.000 euro.*

**9.2** Për apartamentin në {\*\*\*}, subjekti pretendon se nuk ka kryer deklaram të rremë për shitësit dhe se nuk ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e tij, pasi është blerë me fondet e siguruar nga një kredi me kushte lehtësuese të marrë në BKT-së në vitin 2011. Kredia me kushte lehtësuese është marrë në vitin 2011, pasi ai ka plotësuar dokumentacionin përkatës (kriteret për

marrjen e saj) dhe nuk ka kryer asnjë deklaram të rremë dhe fiktiv në lidhje me faktin se nuk dispononte asnjë pronë të paluajtshme në vendin e ushtrimit të detyrës. Provohet ekzistenca e burimeve të ligjshme për shlyerjen e kredisë në NBG Bank në vitin 2011, si edhe për krijimin e shumës prej 1.900.000 lekësh, gjendur në llogarinë rrjedhëse pranë BKT-së.

**9.3** Për blerjen e obligacioneve në tregun primar në vitet 2015 dhe 2016, subjekti pretendon se ato janë blerë prej tij me të ardhurat e krijuara nga puna dhe nga qiratë, për të cilat ai ka paguar të gjitha detyrimet tatimore.

**9.4** Për vëllanë, z. S.Rr., dhe kunatën, znj. A.Rr., subjekti kundërshton analizën e kryer nga Komisioni lidhur me aktivitetin tregtar që ata ushtrojnë me kompaninë “{\*\*\*}”, pasi nuk është e justifikuar në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 konsiderimi i tyre si persona të tjerë të lidhur; gjithashtu subjekti parashtron se vëllai dhe kunata e tij nuk i kanë dhënë asnjë borxh shoqërisë “{\*\*\*}” dhe se shuma e evidentuar në vendimin nr. 55, datë 31.07.2018, si borxh i shoqërisë ndaj S. e A.Rr. është detyrim ndaj kreditorëve të shoqërisë “{\*\*\*}”.

**9.5** Subjekti kundërshton analizën e kryer nga Komisioni lidhur me llogarinë në Raiffeisen Bank të nënës së tij, znj. Xh.Rr., pasi pretendon se nuk është e justifikuar në kuptim të neneve 3 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016 konsiderimi i saj si person tjetër i lidhur por, edhe nëse do të trajtohej si i tillë, ajo ka burime të ligjshme për të krijuar këtë pasuri.

**9.6** Përfundimin e procesit të tij të rivlerësimit bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, subjekti e konsideron si vendimmarrje të paragjykuar dhe të paracaktuar.

**9.7** Lidhur me bazën ligjore të aplikuar nga Komisioni në vendimin nr. 55, datë 31.07.2018, subjekti shprehet se neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 kërkon në mënyrë kumulative edhe bashkekzistencën e papërshtatshmërisë në lidhje me kriterin e pastërtisë së figurës dhe të pamjaftueshmërisë së deklaramit të pasurisë.

**9.8** Raportit të Inspektorit të Lartë të Deklaramit të Pasurive, i hartuar për të, nuk duhej t’i jepej vlerë provuese nga Komisioni pasi ai është hartuar nga persona në konflikt të hapur interesi me subjektin e rivlerësimit.

**10.** Në mbështetje të shkaqeve të ankimit dhe të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë provash të reja, për të cilat ai ka kërkuar të shqyrtohen prej trupit gjykues në këtë gjykim, pasi sipas tij ato provojnë pretendimet e tij rreth pabazueshmërisë së vendimit të Komisionit.

**11.** Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, duke analizuar provat e reja të paraqitura në pikëpamje të formës dhe përmbajtjes së pretenduar, në raport me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë moment procedural, dhe konstatoi sa më poshtë.

Në drejtim të momentit procedural të paraqitjes së tyre, një pjesë e provave janë paraqitur së bashku me ankimin e subjektit të rivlerësimit, si në vijim.

1) Deklarata noteriale të familjarëve të subjektit, përkatësisht z. B.Rr. me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 22.10.2018, znj. A.Rr. me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 22.10.2018; z. M.Rr. me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 05.11.2018, me anë të të cilave kërkohet të provohet koha e fillimit dhe e mbarimit të banesës me 3 kate në vitin 2004, si dhe kontributet financiare për ndërtimin e saj.

2) Deklarata të personave që janë marrë me punimet, si z. L.Rr. me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2018, z. P. Q. me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 01.11.2018, si dhe deklarata e fqinjit, z. J.Xh. me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 30.10.2018, me anë të të cilave kërkohet të provohet koha e fillimit dhe e mbarimit të banesës 3 kate në vitin 2004.

3) Raporti i Hartografisë të administruar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK më datë 03.11.2018, tek i cili thuhet se në zonën kadastrale {\*\*\*}, indeks harte {\*\*\*}, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë dhe planeve të rilevimit të shoqëruara me orthofoto nga “Google earth”, rezulton se nuk ka ndërtim mbi sipërfaqe të ndërtuar para muajit janar 2004, duke vënë në dispozicion imazhet sipas viteve.

4) Kontratë furnizimi me energji elektrike të lidhur me nga OShEE, me nr. {\*\*\*}, në emër të vëllait të subjektit, z. B.Rr., e cila është lidhur më datë 07.02.2010, ndërmjet tij dhe OShEE-së për një banesë private kati i parë, Tiranë, e cila sipas pretendimit të subjektit është kati i parë i banesës në bashkëpronësi. Në këtë akt pasqyrohen edhe të gjitha pagesat e kryera nga z. B.Rr. për llogari të OShEE-së.

5) Certifikatë martese e subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka dhe e vëllait të tij, z. B.Rr., nga të cilat rezulton se subjekti ka lidhur martesë më datë 16.07.2007 dhe vëllai i tij më datë 04.08.2007 dhe se të dy vëllezërit në këtë akt të vitit 2007 kanë deklaruar si adresë banimi shtëpinë në rrugën “{\*\*\*}”, Njësia Administrative nr. {\*\*\*}, Tiranë.

6) Deklarata e pasurisë e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. B.Rr., e dorëzuar në zbatim të ligjit nr. 12/2018, datë 04.05.2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme”, tek e cila janë pasqyruar si pasuri të paluajtshme në pronësi të tij, kati i parë 166 m<sup>2</sup>, i ndërtuar në vitin 2004 dhe kati i fundit karabina, me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, i objektit në bashkëpronësi, ndërtuar në vitin 2009.

7) Shkresë e Policisë Shkodër nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2018, për të ardhurat e siguruar nga vëllai i subjektit nga puna pranë kësaj drejtorie policie në periudhën gusht 2002 deri më janar 2005.

8) Libreza e kursimit pranë Bankës Kombëtare Greke, me nr. llogarie {\*\*\*}, e vitit 1998, e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. B.Rr., e cila sipas subjektit provon faktin që në këtë periudhë vëllai i tij ka qenë emigrant në {\*\*\*}/Greqi, ku ka siguruar të ardhura nga puna dhe ka kryer veprime bankare të ndryshme në llogarinë e tij.

9) Akt ekspertimi kontabël i datës 06.11.2018, nga i cili rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. B.Rr., ka pasur të ardhura të mjaftueshme dhe nga burime të ligjshme për të mbuluar kontributin e tij në ndërtimin e shtëpisë.

10) Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., e datës 31.10.2018 e ortakëve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, R.B. dhe H.R., ku ata japin shpjegime lidhur me historikun e marrëdhënies që subjekti ka pasur me ta për marrjen e kredisë, si edhe për blerjen dhe shitjen e apartamentit me sipërfaqe 97,8 m<sup>2</sup>, duke deklaruar edhe se shuma prej 1.250.000 lekësh është mbuluar prej tyre në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe shlyerja e saj është bërë më vonë nga subjekti në vitet 2014, 2015 dhe 2016.

11) Deklarata noteriale e noteres N.K., me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 05.11.2018, e cila ka hartuar kontratën e shitjes së apartamentit në {\*\*\*}, para së cilës janë bërë diskutimet ndërmjet subjektit dhe ortakëve të firmës “{\*\*\*}” ShPK, për marrjen përsipër nga ana e tyre të pagesës në vlerën 1.250.000 lekë, në momentin e nënshkrimit të kontratës në vitin 2011.

12) Shkresa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2018, në të cilën shprehet se subjekti i rivlerësimit ka paguar detyrimet tatimore që lidhen me tatimin mbi fitimin për qiranë për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 dhe se pagesat nuk janë kryer në vitin 2018, pasi ato janë kryer vite më parë. Gjithashtu, sqarojnë se para muajit nëntor të vitit 2014 tatimi mbi qiranë

ka qenë i painformatizuar (jashtë sistemi) dhe, duke filluar nga data 01.12.2014, ky tatim është implementuar në sistem.

13) Shkresë e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan, nr. {\*\*\*}, datë 06.08.2018, nëpërmjet së cilës përcillet përgjigjja e kontrollit tatimor për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën pasqyrohet ndër të tjera se shoqëria nuk ka detyrime ndaj ortakëve S. dhe A.Rr.

14) Akt ekspertimi kontabël i datës 02.11.2018, nga i cili rezulton se depozita prej 3,8 milionë lekësh të reja, në emër të znj. Xh.Rr., është plotësisht e mbulueshme nga të ardhura me burim të ligjshëm të nënës dhe babait të subjektit ndër vite.

12. Subjekti i rivlerësimit pas paraqitjes së ankimit rezulton se ka paraqitur në vazhdimësi në Kolegj, akte të tjera me cilësinë e provave të reja, të cilat konkretisht renditen si më poshtë.

12.1 Shkresa e Drejtorisë Tatimore Rajonale Elbasan, me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2019, me objekt: “Dërgohen raportet e kontrollit tatimor me nr. {\*\*\*}, datë 31.12.2018, për shoqërinë “{\*\*\*}”.

12.2 Shkresa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan, me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.03.2019, me objekt: “Dërgohet shkresa nr. {\*\*\*}, datë 08.03.2018”, si dhe shkresa nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2018, e Entit Kombëtar të Banesave, me të cilat janë bashkëlidhur:

a) shkresa nr. {\*\*\*} e datës 08.03.2019 e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan drejtuar S. Rr., e sjellë me qëllim sqarimin e situatës së shoqërisë “{\*\*\*}”;

b) shkresa nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2018, e Entit Kombëtar të Banesave, drejtuar z. Dritan Rreshka, ku jepen shpjegime për koston mesatare të ndërtimit.

12.3 Shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.03.2019, me objekt: “Dërgohen vërtetimet e punës së prefekturës {\*\*\*}, Komuna {\*\*\*} Greqi për M. dhe B.Rr., si dhe vërtetime të lëshuara nga N. Th. S., sipërmarrës i projekteve publike, {\*\*\*} Greqi për Dritan Rreshka”. Bashkëlidhur kësaj shkrese janë paraqitur:

a) vërtetim pune për shtetasin Dritan Rreshka, deklaruar pranë bashkisë {\*\*\*}, Greqi, i datës 18.02.2019 nga ing. N. Th. S., tek i cili pasqyrohet se Dritan Rreshka gjatë viteve 1997-1998 ka punuar si punëtor në punë të rënda ndërtimore në projekte të ndryshme publike e private, për 370 ditë dhe paga ditore varionte rreth 12.000 dhrahmi në ditë;

b) vërtetim pune për shtetasin M.Rr. (babai i subjektit), i lëshuar nga Komuna {\*\*\*}, i datës 28.02.2019, në të cilin pasqyrohet se ky shtetas ka qenë mbajtës i lejes së qëndrimit {\*\*\*}, e vlefshme deri më 13.01.2002 dhe se ka punuar punë blegtorie, i strehuar pranë punëdhënësve përkatës të tij për një periudhë 24-mujore, për 30 ditë në muaj, me një pagë ditore që varionte rreth 5.000 dhrahmi në ditë;

c) vërtetim pune për shtetasin B.Rr. (vëllai i subjektit), i lëshuar nga Komuna {\*\*\*}, i datës 20.02.2019, në të cilin pasqyrohet se ky shtetas ka qenë i punësuar në fermat blegtorale të komunës dhe është strehuar pranë punëdhënësve. Vërtetimi shpreh se ky shtetas ka qenë i punësuar vazhdimisht për një periudhë 2- (dy-) vjeçare gjatë viteve 1999-2000 dhe në vitin 2001 në punë sezonale çdo 4 muaj gjatë verës, për 30 ditë çdo muaj, me pagë ditore që varionte rreth 5.000 dhrh në ditë.

12.4 Shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2019, me objekt: “Dërgohen vërtetimet e punësimit të lëshuara nga Ministria e Punës, Sigurimeve Shoqërore dhe Mirëqenies Sociale, Qendra për Promovimin e Punësimit nr. {\*\*\*}, {\*\*\*} Greqi, për Dritan e B.Rr., si dhe vërtetimet si të siguruar të drejtpërdrejtë në regjistrin e personave të siguruar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Dega {\*\*\*}, {\*\*\*} Greqi për Dritan dhe B.Rr.”, bashkëlidhur së cilës janë paraqitur këto dokumente:

- a) vërtetim i lëshuar nga Ministria e Punës, Sigurimeve Shoqërore e Mirëqenies Sociale, Organizimi i Punësimit të Fuqisë Punëtore, {\*\*\*}, datë 04.03.2019, nr. {\*\*\*}, për z. Dritan Rreshka (dokumenti është në gjuhën greke, i pajisur me vulë apostile);
- b) vërtetim i lëshuar nga Ministria e Punës, Sigurimeve Shoqërore e Mirëqenies Sociale, Organizimi i Punësimit të Fuqisë Punëtore, {\*\*\*}, datë 04.03.2019, nr. {\*\*\*}, për z. B.Rr. (dokumenti është në gjuhën greke, i pajisur me vulë apostile);
- c) dokument i lëshuar nga regjistri i të siguruarve, dega {\*\*\*}, datë 08.04.2019, me emërtimin “Vërtetim regjistrimi si i siguruar i drejtpërdrejtë për z. Dritan Rreshka” (dokumenti është në gjuhën greke, i pajisur me vulë apostile);
- ç) dokument i lëshuar nga regjistri i të siguruarve, dega {\*\*\*}, datë 08.04.2019, me emërtimin “Vërtetim regjistrimi si i siguruar i drejtpërdrejtë për z. B.Rr.” (dokumenti është në gjuhën greke, i pajisur me vulë apostile).

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

###### I) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të bëjë shqyrtimin e ankimeve të subjekteve të rivlerësimit kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e tyre, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka me detyrë prokuror, drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### II) Legjitimimi i ankuesit

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### III) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në zbatim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe neneve 49 e 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 55, datë 31.07.2018, u mor në shqyrtim në dhomë këshillimi.
16. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “Kolegji”) shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve që ai i ka bashkangjitur ankimit dhe të akteve të reja të depozituara në Kolegji me korrespondencë, pas depozitimit të ankimit.  
Analiza e pranueshmërisë për shqyrtim ose jo të këtyre provave, lidhet me zbatimin e normave ligjore që rregullojnë situatën në fjalë. Kolegji e mbështeti vendimin e tij në këtë rast në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte*



ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj, dispozitë kjo e detyrueshme për zbatim në referim të nenit 65/1 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, analiza e këtij pretendimi u mbështet edhe në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon:

*Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur:*

*a) marrja e provës duket se është e panevojshme;*

*b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyqimit;*

*[...]*

*d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.*

17. Në verifikim të këtyre parashikimeve ligjore në rastin konkret, Kolegji çmoi se provat e paraqitura prej subjektit bashkëlidhur ankimit, përveç se nuk mbështeteshin mbi fakte që provonin mospasjen mundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ, siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 por, edhe sikur të ishin në plotësim të këtyre kriterëve, ato u konsideruan prej Kolegjit si të panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 për më tepër dhe si të tilla që, edhe sikur të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti kërkon të provojë nëpërmjet tyre, përsëri ato nuk mund të ndikonin në marrjen e vendimit, në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “d”, e cituar më lart.
18. Në vijim të arsytimit të këtij vendimi, Kolegji analizon në mënyrë edhe më të detajuar, shkaqet dhe arsyet e këtij vendimi për mosmarrjen në shqyrtim të provave të reja, duke përdorur si metodë arsyetimi edhe versionin në të cilin faktet e pretenduara se do të provoheshin me provat e reja, të konsideroheshin si të vërteta.
19. Për sa u përket provave të paraqitura prej subjektit me korrespondencë, pas paraqitjes së ankimit (pra, jo bashkëlidhur ankimit), Kolegji arsyeton se së pari ato nuk plotësojnë kërkesën bazike të parashikuar prej nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 që parashikon se diskutimi mbi marrjen ose jo të një prove të re do të bëhet mbi provat që i bashkëlidhen ankimit, për të cilat plotësohen edhe kushtet e tjera të kësaj dispozite. Fakti që këto prova nuk janë paraqitur bashkë me ankimin, i përjashton ato nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre, për sa i takon zgjidhjes së çështjes. Pavarësisht këtij argumenti formal të mospranueshmërisë së tyre për shqyrtim, Kolegji konstaton se në një vlerësim tërësor të çështjes, edhe këto akte nuk do të arrinin të ndikonin në zgjidhjen e çështjes.
20. Për të gjitha arsyet që u renditën më lart, Kolegji vendosi të mos pranojë marrjen në shqyrtim të akteve të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, siç u përshkrua më lart, dhe duke qenë se as Kolegji vetë nuk konstatoi ekzistencën e asnjë prej kushteve të parashikuara prej nenit 51 të ligjit nr. 49/2016, i cili parashikon rastet se kur një gjykim administrativ në Gjykatën e Apelit zhvillohet në seancë publike gjyqësore, vendosi ta shqyrtojë çështjen në formën e gjyqimit në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

## **B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit**

### **I. Shkaqe që lidhen me kontrollin e pasurisë**

21. Nga shqyrtimi në tërësi i ankimit të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se shkaqet e tij të ankimit që lidhen me pasurinë dhe konkluzione konkrete të Komisionit janë ndërthur edhe me elemente ankimore që lidhen me elemente të procesit të rregullt e që sipas subjektit i kanë cenuar atij të drejtat

procedurale dhe kanë afektuar dhe ndikuar në marrjen e një vendimi të padrejtë për të. Kolegji, në trajtimin e shkaqeve të ankimit si më poshtë, do të trajtojë këto elemente në raport me shkaqet e ankimit që u adresohen qëndrimeve konkrete, duke u shprehur edhe për ndikimin e këtyre shkeljeve të pretenduara në vendimin e Komisionit.

22. Subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka ka kundërshtuar në të gjitha konkluzionet qëndrimin që ka mbajtur Komisioni pas verifikimit të pasurisë së tij objekt banimi, e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}/Tiranë”, duke pretenduar se vendimi i Komisionit për këtë pasuri është i padrejtë për shkaqet e mëposhtme.

22.1 Komisioni ka gabuar në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në lidhje me kohën e fillimit të punimeve për ndërtimin e banesës dhe ka arritur në një konkluzion të gabuar edhe për sa i përket kohës së ndërtimit të tri kateve të para, e cila sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit i përket fundit të vitit 2003 deri në qershor 2004 dhe jo viti 2003, siç ka konkluduar Komisioni.

22.2 Vlera e ndërtimit të banesës me 5 kate nuk është 18 143 052 lekë, siç e ka përcaktuar Komisioni në referim të çmimit mesatar të ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, por është një vlerë prej 8 572 764 lekësh, e nxjerrë nga një akt ekspertimi teknik i kryer nga ekspertë të fushës së ndërtimit, sipas kërkesës së subjektit. Vlera e përcaktuar nga ekspertët është përafërsisht ajo e deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, për pasojë është i padrejtë qëndrimi i Komisionit që ka konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rreme në lidhje me vlerën e ndërtimit të kësaj pasurie.

22.3 Padrejtësisht dhe në kundërshtim me provat e administruara, Komisioni ka konkluduar për mungesën e burimit të ligjshëm për ndërtimin e banesës, duke mos njohur si të ardhura të ligjshme të përdorura për ndërtimin e saj të ardhurat e fituara në emigracion prej subjektit dhe vëllait e tij, si edhe moskonsiderimin si të ardhur e përdorur për ndërtimin e banesës as kredinë në vlerën prej 18 000 eurosh, të marrë prej subjektit në bankën NBG në muajin prill 2004.

22.4 Në kundërshtim me provat e administruara, Komisioni nuk ka konsideruar si burim për ndërtimin e banesës të ardhurat e siguruar nga puna e vëllait B.Rr. dhe babait M.Rr..

22.5 Komisioni ka gabuar në konkluzionin se është kryer fshehje e pasurisë për dy kate të banesës, përkatësisht kati i parë dhe i katërt, sepse kjo pasuri ka qenë vetëm formalisht e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit për shkak të procedurës së legalizimit të ndjekur, por në fakt kjo pasuri ka qenë pronë e vëllait të subjektit B.Rr..

23. Në këndvështrim të rrethanave të faktit në lidhje me këtë pasuri, Kolegji ka konstatuar se ato paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë. Pasuria objekt verifikimi, e cilësuar si banesë ndodhet në rrugën “{\*\*\*}/Tiranë” dhe përbëhet nga një kat përdhes dhe katër kate mbi tokë me një sipërfaqe të përgjithshme, të dhënë në lejen e legalizimit prej 734 m<sup>2</sup>. Të drejtat e pronësisë së subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri rezultojnë të jenë fituar në mënyrë origjinare, nëpërmjet ndërtimit të kësaj godine në rrugë informale prej subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij dhe përfitimit nga zbatimi i procesit të legalizimit të kryer nëpërmjet Agjencisë së Legalizimit,

Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale (në vijim ALUIZNI), i cili legalizoi ndërtimet e kësaj natyre në plotësim të kriterëve ligjore respektive.

Kjo banesë rezulton të jetë ndërtuar mbi një truall të blerë prej subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kontratës së shitblerjes të datë 25.10.2000, të lidhur pranë noterës publike T.M., me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, me vlerë 800.000 lekë, i regjistruar në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (në vijim ZRPPT), në emër të Dritan Rreshkës, me vërtetim hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 26.10.2000.

Banesa në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë është regjistruar në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka, sipas përcaktimeve të bëra në lejen e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 20.02.2012, e dhënë për godinë 5 kate, në zonën kadastrale {\*\*\*}, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe parcele ndërtimore 263,3 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 131,4 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe totale të ndërtimit (për banim) 734 m<sup>2</sup>, me 5 (pesë) kate mbi tokë.

Pas lëshimit të lejes së legalizimit, kjo godinë me 5 (pesë) kate është regjistruar në regjistrat hipotekorë pranë ZRPP Tiranë, me të dhënat përkatëse<sup>1</sup>:

Subjekti i rivlerësimit ka kaluar pronësinë mbi katin e parë të banesës të vëllai i tij, z. B.Rr., nëpërmjet kontratës së dhurimit me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2012, të hartuar nga noterja publike M.Ll. Më pas subjekti i rivlerësimit ka kaluar pronësinë e katit të fundit të banesës (katit i katërt) të vëllai i tij, z. B.Rr., nëpërmjet kontratës së dhurimit të hartuar nga noterja publike M.Ll., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 10.01.2017.

24. Rezulton se subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri ka bërë deklaratimet vijuese. Në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar:

- *truall me sipërfaqe 293 m<sup>2</sup>, i blerë më datë 25.10.2000, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë;*
- *kati përdhes dhe i dytë i një shtëpie private të ndërtuar vetë mbi truallin e sipërpërshkruar në vitet 2003 dhe 2004 dhe të legalizuar, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, me sipërfaqe kati përdhes 131 m<sup>2</sup> dhe kati i dytë 166,9 m<sup>2</sup>;*
- *Kati i 3-të i së njëjtës shtëpie private, i ndërtuar vetë në vitin 2009 (karabina), me sipërfaqe 166 m<sup>2</sup> dhe i regjistruar në zonën kadastrale {\*\*\*} pranë ZVRPP Tiranë.*

25. Në deklaratën periodike që i përket vitit 2003, ka deklaruar:

- *truall 300 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, Tiranë, me vlerë 0,8 milionë lekë, me burim: të ardhurat nga puna si përkthyes anglishteje nga viti 1997 deri në tetor 1998 në Greqi.*

Në deklaratën periodike që i përket vitit 2004, ka deklaruar:

- *shtëpi private me 2(dy) kate (në proces legalizimi), vlera 2.500.000 lekë, pjesa takuese 100%, data dhe viti i krijimit të pasurisë, gjatë vitit 2004;*
- *kredi 18.000 euro, kohëzgjatja 17 vjet (8,9%), me nr. {\*\*\*} rep. dhe {\*\*\*} kol., datë 15.04.2004, marrë pranë NBG, vlera e shlyer deri më 31.12.2004 është 1.320 euro, mbeten për t’u shlyer edhe 16.680 euro.*

---

<sup>1</sup> *Kati përdhes, me nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 131,4 m<sup>2</sup>, në emër të Dritan Rreshkës; kati i parë me nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe prej 166,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka; kati i dytë, me nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 166,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka; kati i tretë, me nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 166,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka; kati i katërt me nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 110,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.*

Në deklaratën periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar vetëm vijimin e shlyerjes së kredisë dhe asnjë shtesë apo pakësim të pasuritë e paluajtshme. E njëjtë paraqitet situata e tij deri në vitin 2008, vit në të cilin, lidhur me kredinë e NGB Bank, subjekti deklaron: *Kredi marrë në vitin 2004 për ndërtim shtëpie banimi, me këst mujor 173 euro. Pague deri në vitin 2008, shuma 2.100 euro; mbetet për t'u shlyer shuma 15.300 euro.*

Në deklaratën periodike të vitit 2009, lidhur me pasurinë e paluajtshme banesë subjekti ka deklaruar shtesa me përshkrimin: *shtesë kati mbi ndërtesën aktuale të banimit (gjendet akoma në fazën e karabinasë, e papërfunduar plotësisht) sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>. E ndërtuar vetë, me kontributin financiar personal dhe të familjes (vëllezërve).*

26. Në përfundim të procedurës administrative, Komisioni, pasi ka verifikuar të dhënat e deklaruara prej subjektit në lidhje me këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se disa prej tyre nuk janë provuar si të vërteta, konstatim prej të cilit Komisioni ka dalë në përfundime që kanë ndikuar vendimmarrjen në raport me të gjithë çështjen.
27. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të kontestimit të qëndrimit të Komisionit për sa u përket rrethanave të faktit, të konsideruara ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti, duke analizuar çdo akt shkresor e të dhënë që lidhej me çështjet e veçanta. Kolegji shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit që koha e ndërtimit të kësaj banese ishte viti 2003 dhe jo periudha e fund vitit 2003 – qershor 2004, ishte i gabuar dhe, për pasojë, ishte i gabuar edhe konkluzioni ligjor i mbështetur mbi këtë rrethanë faktike se subjekti ka fshehur kohën e ndërtimit të kësaj pasurie. Konstatohet se Komisioni është mbështetur për të nxjerrë këtë përfundim në deklarinë e bërë prej subjektit të rivlerësimit në formularin për aplikim për legalizimin e kësaj pasurie pranë ALUIZNI-t në datën 21.03.2005. Sipas vetë këtij deklarimi, viti i ndërtimit i kësaj pasurie është tetori 2003, ndërkohë që në deklaratën fillestare të deklarinës të pasurisë të vitit 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”, subjekti nuk ka deklaruar disponimin e kësaj pasurie në asnjë formë. Ai ka deklaruar ndërtimin e dy kateve në deklaratën periodike të vitit 2004 mbi truallin në pronësi të tij, të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003.
28. Përveç të dhënave të cituara më lart, subjekti rezulton se ka dhënë shpjegimet e tij përgjatë hetimit administrativ duke u përpjekur të shpjegojë kontekstin e deklarinës të kryer për efekt të formularit të legalizimit, si të lidhur me fazën fillestare të ndërtimit. Subjekti, në mënyrë të përmbledhur, ka thënë se një deklarinë i tillë është kryer sepse: *[...] Kur kam plotësuar këtë formular në vitin 2005, koha e shënuar në të përfaqëson kohën e fillimit të punimeve. Si në çdo punim të ri, fillimi i punimeve nuk do të thotë fillimi i strukturës beton [...], por punimet fillestare<sup>2</sup> janë ato të rrethimit, sheshimit dhe lëvizjes së dheut, hapjes së gropave etj. [...] Punimet nuk kanë vazhduar deri në janar*

---

<sup>2</sup> Referuar legjisllacionit të aplikuar në vitin 2005 për përkufizimin e termit “Objekt ndërtimor”, gjejmë sa vijon: Në rregulloren e urbanistikës të miratuar me VKM-në nr. 722, datë 19.11.1998, në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për Urbanistikën” i ndryshuar, e cila ka qenë në fuqi deri në shtator 2012, në pikën 115 të saj jepet përkufizimi i objektit të ndërtimit si vijon: “[...] Objekt ose ndërtim do të quhet çdo masë që formon vëllimin ose sipërfaqe ndërtimore, e cila krijon hije dhe ngrihet në lartësi, përveç pemëve ose gjelbërimeve të larta.”

*2004, kur kanë filluar punimet e ndërtimit të strukturës së ndërtesës me hedhjen e betonit të themeleve, blintave dhe punimet vazhduese.*

Përtej këtij argumenti, Kolegji konstaton se relevante në këtë çështje është përmbajtja e shkresës së emërtuar “Leje punimesh”, me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.06.2004, e lëshuar nga Bashkia Tiranë, sipas së cilës lejohet subjekti Dritan Rreshka të kryejë punime në përputhje me projektin e paraqitur prej tij për furnizimin me ujë të objektit 3-katësh në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë. Duke analizuar të dhënat e përmendura më lart, Kolegji arrin në konkluzionin se si kohë e përfundimit të ndërtimit të tri kateve të para të objektit duhet të konsiderohet qershori i vitit 2004, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

29. Kolegji çmon se vlera përcaktuese për vërtetësinë e këtij fakti që Komisioni i ka dhënë vetëdeklarimit të subjektit në formularin për legalizimin e banesës, nuk është një vlerësim i drejtë i çdo të dhëne që ka rezultuar prej hetimit. Së pari, vihet re që edhe ky dokument mbështet në një vetëdeklarim të subjektit të rivlerësimit, i kryer në funksion të një procesi tjetër, në të cilin koha e ndërtimit të objektit, për sa kohë që ishte realizuar para vitit 2005, kur po bëhej ky vetëdeklarim, nuk ishte relevante për ndonjë efekt tjetër. Ndërkohë që deklaratat e bëra po prej subjektit në deklaratat periodike të pasurisë janë të kryera në një kontekst krejt tjetër, pasaktësia e të cilave në çdo kohë, që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ka qenë parashikuar të prodhojë pasoja në karrierën e subjektit të rivlerësimit, për konsekuencë detajimi i kohës së ndërtimit në këtë deklaratë merr një vlerë dominuese, pasi edhe në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratat periodike të pasurisë kanë një vlerë provuese të parashikuar në mënyrë të posaçme nga ligji. Gjithashtu ky deklaram i subjektit të rivlerësimit gjen mbështetje edhe nga indicia e përfutur prej shkresës së Bashkisë Tiranë, e cila tregon se në mënyrë të ligjshme koha e furnizimit me ujë e kësaj godine është pikërisht qershori 2004, pra në një arsyetim në të kundërt, objekti banesë nuk ka qenë i furnizuar me ujë deri në këtë datë, fakt që të shtyn të besosh se godina nuk ka qenë e përfunduar dhe funksionale deri në atë periudhë, për sa kohë pranohet se objekti është përdorur për qëllime banimi që në atë kohë.
30. Në rrethanat kur i vetmi dokument në të cilin mbështet konkluzioni i Komisionit në lidhje me kohën e ndërtimit të këtij objekti, mbetet vetëm deklarami i subjektit të rivlerësimit në formularin e ALUIZNI-t dhe në të kundërt të këtij deklarami kemi po deklarime të subjektit të rivlerësimit të kryera që në vitin 2005, pra jo në funksion të procesit të rivlerësimit, dhe që për më tepër mbështeten edhe nga indicie të tjera, si ajo e nxjerrë prej shkresës së Bashkisë, por edhe nga deklarami i destinacionit të kredisë së marrë prej subjektit nga NBG e të deklaruar si për qëllime të ndërtimit të shtëpisë që në deklaratën periodike të vitit 2008, e çon Kolegjin në konkluzionin se si kohë e ndërtimit të objektit banesë, për efekt të këtij procesi, duhet të konsiderohet periudha përgjatë fund vitit 2003 - qershor të vitit 2004, e deklaruar prej subjektit të rivlerësimit.
31. Kolegji shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vlera e ndërtimit të banesës 5 kate nuk është 18.143.052 lekë, siç e ka përcaktuar Komisioni në referim të çmimit mesatar të ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave (në vijim EKB), por është një vlerë prej 8.572.764 lekësh, e nxjerrë nga

një akt ekspertimi teknik, i kryer nga ekspertë të fushës, sipas kërkesës së vetë subjektit<sup>3</sup>, duke sqaruar se vlera e përcaktuar nga ekspertët është përafërsisht ajo e deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën e pasurisë dhe, për pasojë, është i padrejtë qëndrimi i Komisionit që ka konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në lidhje me vlerën e ndërtimit të kësaj pasurie.

32. Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji, së pari konstaton se vlera e objektit, e përcaktuar prej Komisionit në përfundim të hetimit administrativ, prej 18.143.052 lekësh, ka ardhur si pasojë e llogaritjes së kësaj vlere duke aplikuar tarifën e përcaktuara nga EKB për koston mesatare të ndërtimit, e cila është aplikuar respektivisht për tri katet e para me vlerën e deklaruar për vitin 2003, kurse për katin e katërt dhe katin e pestë me vlerën e vitit 2009. Komisioni ka ndjekur këtë metodologji për të përcaktuar vlerën e ndërtimit të këtij objekti, në kushtet kur ai është ndërtuar në mënyrë informale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të paraqesë asnjë lloj dokumentacioni të kohës për të provuar koston reale apo të përafërt të këtij objekti. Subjekti e ka kontestuar këtë vlerë të përcaktuar prej Komisionit, duke arsyetuar se ndërtimi është realizuar me punën dhe kontributin e përbashkët të familjarëve e miqve të tij, duke synuar dhe arritur realizimin e tij me kosto shumë herë më të vogël se ajo e përcaktuar nga Komisioni, në zbatim të tarifave të EKB-së. Subjekti përgjatë gjithë hetimit, por edhe në ankim ka pretenduar një vlerë më të ulët të ndërtimit të objektit.

33. Kolegji konstaton se subjekti i mbështet pretendimet e tij në dy shkaqe thelbësore:  
*Së pari*, vlera e parashikuar prej EKB-së përmban në strukturën e saj disa elemente, të cilat nuk mund të jenë pjesë përbërëse e koston për ndërtime informale, si TVSh, fond rezervë, fitim, kosto e punës së krahut të punës.

*Së dyti*, vlera e vërtetë e ndërtimit të këtij objekti do të përcaktohej nëpërmjet kryerjes së një akt ekspertimi nga ekspertë të fushës, të cilët do të duhej të verifikonin në vend vlerën e punimeve nëpërmjet këqyrjes dhe verifikimit të çdo punimi dhe aplikimit të çmimeve të kohës sipas zërave përkatës. Subjekti e ka paraqitur këtë pretendim edhe në formën e një kërkesë për kryerjen e aktit të ekspertimit prej vetë Kolegjit gjatë shqyrtimit të çështjes në bazë të ankimit të tij. Për të bindur trupin gjykues, gjithashtu ai kërkon të konsiderohet si vlerë e objektit ajo që është përcaktuar në aktin e ekspertimit teknik të hartuar prej ekspertëve të caktuar prej tij, Ing. P.H. dhe Arkitekte R.Sh., të datës 16.07.2018, në të cilin vlera e objektit përcaktohet në shumën 8.572.764 lekë.

Kolegji pasi shqyrtoi këtë shkak ankimor, mbështetur në të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, si edhe duke analizuar strukturën dhe elementet përbërëse të vlerës së koston të përcaktuar prej EKB-së<sup>4</sup>, në udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, konstatoi se si elemente të strukturës së koston së punimeve të ndërtimit përfshihen 3 kategori: shpenzimet e drejtpërdrejta; shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh). Kolegji me qëllim marrjen e një informacioni mbi aplikimin e këtij udhëzimi (detajimin e koston) i është drejtuar EKB-së për të përcaktuar se sa peshë zënë

<sup>3</sup> Ky akt ekspertimi është hartuar nga dy ekspertët, Ing. P. H. dhe Ark. R.Sh., më datë 16.07.2018 dhe është paraqitur pranë Komisionit si provë nga subjekti, në shpjegimet e dhëna prej tij për rezultatet paraprake të hetimit.

<sup>4</sup> Në udhëzimin e EKB-së nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”.

kategoritë e mësipërme në koston mesatare të ndërtimit, të publikuara nga ky institucion në rastin e një ndërtimi të kryer në vitin 2004 dhe 2009. EKB-ja me shkresën e saj nr. {\*\*\*} prot., datë 07.03.2019<sup>5</sup>, ka dhënë informacion mbi përqindjet që zënë 3 kategoritë e koston në çmimin mesatar të ndërtimit për vitet e kërkuara.

34. Nga analizimi i udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003, si dhe i shpjegimeve të sjella nga EKB-ja, Kolegji konstatoi se çështjet që shtrohen për zgjidhje në raport me këtë shkak ankimi janë si më poshtë:
1. Nëse vlera e përcaktuar prej Komisionit, në referim të koston mesatare të ndërtimit për objektin në verifikim është e saktë dhe duhet të përdoret si referim për vlerën e banesës.
  2. Nëse, në verifikim të vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të kësaj vlere, ai ka bërë ose jo deklaram të rremë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.
35. Në lidhje me çështjen e parë, Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e mbajtur prej Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij, në këtë rast të lidhura ngushtë me vlerën që do të pranohet se ka pasuria banesë në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë. Ky detyrim buron nga parashikimi i nenit Ç, pika 5 dhe nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, por pavarësisht kësaj subjekti nuk ka paraqitur as bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* dhe as përgjatë hetimit administrativ, dokumentacion justifikues i cili do të provonte deklaramet e tij për vlerën e kësaj pasurie. Në kushtet kur kjo pasuri është krijuar prej tij, subjekti i rivlerësimit në kuptim të këtyre dispozitave të përmendura më lart, kishte detyrimin të provonte vlerën e saj nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit justifikues që do të vërtetonte pagesat e kryera ose të parashikuara se do të kryheshin për ndërtimin e saj, çdo akt shkresor që do të dokumentonte shpenzimet e kryera prej tij apo prej familjarëve për ndërtimin e kësaj banese. I vetmi akt i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim është akti i ekspertimit teknik, i hartuar prej dy ekspertëve të kontraktuar prej tij, për nevoja të procesit të rivlerësimit.
- Me të drejtë Komisioni nuk e ka konsideruar me vlerë provuese këtë akt ekspertimi, përtej faktit që ai është hartuar nga ekspertët, siç rezulton në përgjigje të kërkesave dhe sugjerimeve apo fakteve të servirura prej subjektit dhe të pacertifikuara nga ndonjë autoritet publik, po në funksion të procesit të rivlerësimit, por edhe sepse në brendinë e tij, vetë akti nuk detajon zërat apo çmimet e referencës, as përcakton volumet e punës të konstatuara në banesë dhe as garanton se koston e përcaktuara në të janë konkluzion i një këqyrjeje të plotë e analize të gjithanshme, e cila do të krijonte një panoramë të besueshme për çdo zë punimesh e vlerë respektive të koston.
36. Në këto rrethana, edhe Kolegji e konsideron se ky akt ekspertimi, i hartuar mbështetur në këto elemente, nuk mund të përdoret si referim për vlerën e kësaj pasurie. Referimi që Komisioni ka bërë te kostoja mesatare e ndërtimit, e përcaktuar ndër vite prej EKB-së, çmohet si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi, të sjellë prej

<sup>5</sup> Në shkresën e EKB-së nr. {\*\*\*} prot., datë 07.03.2019, dërguar Kolegjit, shpjegohet se metodologjia e llogaritjes së koston bazohet në strukturën e koston të përcaktuar në manualet e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe, sipas formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, të miratuar me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, ku përfshihen: 1. shpenzime të drejtpërdrejta në lekë (për pagat, dhe shtesën mbi pagat); 2. shpenzimet e përgjithshme (shpenzime suplementare + ngritje kantieri) dhe fitimi i planifikuar në përqindje. Në këtë shkresë sqarohet se në analizën e çmimeve nuk përfshihet TVSh-ja dhe se mbi bazën e analizës teknike të çmimit, në preventiv aplikohet 5% fond rezervë dhe 20% TVSh.

subjektit të rivlerësimit. Kolegji shqyrtoi në gjykim pretendimin e subjektit për vlerën e lartë të koston së përcaktuar prej Entit Kombëtar të Banesave, për shkak të faktit së pjesë përbërëse e kësaj kostoje janë edhe elementet të cilat në mënyrë të logjikshme nuk bëjnë pjesë të shpenzimet apo kostoja e një ndërtimi informal, për shkak të specifikave të realizimit të këtyre ndërtimeve, siç janë kryerja nga familjarë dhe miq të familjes e disa proceseve apo punëve të caktuara, përjashtimi i TVSh-së, i fondit rezervë, moshartimi i një projekti të mirëfilltë, fakti se dy katet e fundit janë ende në gjendjen karabina etj.

37. Kolegji, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, në këndvështrim të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe për të garantuar një gjykim sa më të drejtë, realizoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit edhe duke konsideruar hipotetikusht si vlerë të objektit 5-katësh, vlerën e dalë duke zbritur nga çmimi për metër katror, sipas koston së përcaktuar prej Entit Kombëtar të Banesave, shumatoren e vlerave që përfaqësojnë TVSh + Fitim + Fond rezervë<sup>6</sup>, të cilat janë pretenduar prej subjektit si të zbritshme dhe të cilat mund të identifikoheshin si të tilla nga aktet që ndodhen në dosje. Në këtë vlerësim, nuk u konsideruan si vlera hipotetikusht të zbritshme: kostoja për hartimin e projektit të ndërtimit dhe as ajo e shpenzuar për fuqinë punëtore, të cilat në vlerësimin e Kolegjit janë shpenzime të kryera detyrimisht për ndërtimin e një godinë prej 5 katesh, pavarësisht se vlera e tyre mund të jetë e ndryshme nga ajo që përcakton struktura e çmimit për metër katror, sipas përcaktimeve të EKB-së. Gjithashtu, Kolegji nuk konsideroi si të zbritshme në këtë version hipotetik as diferencat që mund të vijnë për shkak të gjendjes së pretenduar si karabina për dy katet e fundit të banesës, duke qenë se nuk ka asnjë kriter ligjor, në referim të të cilit kjo diferencë bëhet e matshme dhe as subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor që të përcaktojë këtë vlerë, për më tepër kur referuar certifikatave të pronësisë së lëshuara nga ZVRPP Tiranë për dy katet e fundit të kësaj banese, ato nuk rezultojnë të regjistruara në statusin e karabinasë, që do të thotë se regjimi i tyre juridik nuk është karabina, por ndërtim i përfunduar.
38. Vlera, sipas kësaj mënyre llogaritjeje, rezultoi të ishte 13468.682 lekë. Kolegji e mbajti në konsideratë këtë vlerë në shqyrtimin e shkakut të ankimit që lidhet me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të financuar ndërtimin e këtij objekti dhe në funksion të shqyrtimit në tërësi të kësaj çështjeje, zgjidhja e së cilës nuk rezultoi se varej detyrimisht nga përcaktimi i vlerës së saktë të ndërtimit të banesës. Pavarësisht kësaj, Kolegji konsideroi për efekt të shqyrtimit në tërësi të çështjes edhe këtë vlerë, e cila u përcaktua në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, për aq sa mund të mbështetej në dokumentacionin ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ. Kolegji çmon se edhe në rast se do të merrte në shqyrtim provat e reja të pretenduara prej subjektit të rivlerësimit, vlerat e vetme që mund të zbriteshin nga vlera e koston së përcaktuar prej EKB-së, do të ishin ato të përshkruara më lart dhe në mungesë të dokumentacionit ligjor që provon vlerën reale të objektit, subjekti do të dështonte të provonte se kjo vlerë është më e vogël se vlera e përcaktuar si më sipër.
39. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar kur ka konkluduar se ai ka kryer deklaram të rremë në lidhje me vlerën e objektit godinë banimi, Kolegji mori në analizë disa rrethana të cilat rezultojnë nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar dhe arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit në këtë drejtim është i drejtë. Siç rezulton nga deklarata e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, ka deklaruar shprehimisht: *kati përdhes dhe i dytë i një shtëpie private, të ndërtuar vetë në vitin 2003 deri në mesin e vitit 2004 dhe të legalizuar, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, me sipërfaqe kati përdhes 131 metra katrorë dhe kati i dytë 166 metra katrorë. Burimi i të ardhurave është nga emigracioni në Greqi, puna pranë {\*\*\*} dhe kontratës së*

<sup>6</sup> Në udhëzimin e EKB-së nr. 2, datë 08.05.2003, të përshkruar në paragrafin 33 më sipër.



*kredisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.04.2004, në vlerën 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, ndërsa në rubrikën “Vlera me shifra dhe fjalë”, ka deklaruar shprehimisht se: përafërsisht 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë të reja. Në lidhje me katin e tretë të deklaruar si pasuri e tij, duke ndjekur të njëjtat rubrika, ai në deklaratën vetting ka deklaruar: kati i tretë i së njëjtës shtëpi private të ndërtuar vetë në vitin 2009 (karabina), me sipërfaqe 166 metra katrorë dhe të regjistruar në zonën kadastrale {\*\*\*} pranë ZVRPP-së Tiranë, ndërsa në lidhje me vlerën e këtij kati ka deklaruar: përafërsisht 600.000 (gjashtëqind) mijë lekë të reja. Të njëjtat deklarime në lidhje me vlerën e këtyre kateve të deklaruara në pronësi të tij, ai i ka dhënë edhe në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2004 dhe për vitin 2009. Në total, vlera e deklaruar prej subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, si në deklaratën vetting, ashtu edhe në ato periodike është 3.100.000 lekë.*

40. Përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vëllai i tij, B.Rr., është financuesi i dy kateve të tjera të godinës, me vlerë financimi, përkatësisht 1.600.000 - 1.800.000 lekë për katin e parë në vitin 2004 dhe 900.000 - 1.000.000 lekë për katin e fundit të saj në vitin 2009, në total përafërsisht 2.800.000 lekë.
41. Sipas aktit të ekspertimit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, edhe sikur të konsiderohej një akt me vlerë provuese, vlera e ndërtimit të këtij objekti është 8.572.764 lekë, pa specifikuar sa i përket secilit kat apo pjesës së pretenduar prej subjektit si e ndërtuar prej tij apo asaj të ndërtuar prej vëllait të tij.
42. Në shpjegimet e tij të dhëna gjatë hetimit administrativ, por edhe në parashtrimin e pretendimeve të tij në ankimin e paraqitur para Kolegjit të Posaçëm të Apelit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një vlerë të ndryshme për pjesën e tij takuese në këtë objekt. Në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni dhe në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, ai ka deklaruar se vlera e gjithë banesës është 8.572.764 lekë<sup>7</sup>, sa kanë përcaktuar ekspertët, ndërsa në ankim<sup>8</sup> ka specifikuar se vlera e pjesës së tij takuese është përafërsisht 5.300.000 lekë, në ndryshim nga vlera që ka deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting dhe në ato periodike. Bashkë me këtë deklaram, subjekti pretendon (si në shpjegimet e dhëna për rezultatet paraprake të hetimit, por edhe në ankim) se përdorimi i shumës prej 18.000 eurosh, të përfituara prej kredisë së marrë në vitin 2004 prej NBG-së, është në fakt pjesë e vlerës së objektit dhe duhet konsideruar në vlerën e tij.
43. Në analizë të gjithë rrethanave të përmendura sa më sipër, Kolegji vëren se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerën e objektit godinë me 5 kate, është ai i kryer në deklaratën vetting, në rubrikën përkatëse ku deklarohen vlerat e pasurisë. Në këtë rubrikë, subjekti ka deklaruar si vlerë të kësaj pasurie shifrën prej 3.100.000 lekësh, për sa i takon pjesës së pasurisë së deklaruar prej tij se i takon. Për efekt të procesit të rivlerësimit, ky deklaram i është nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tij, në zbatim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, çdo vlerë tjetër e deklaruar për këtë pasuri duhet të shërbejë për të konfirmuar ose jo vërtetësinë e këtij deklarimi të kryer në deklaratën e pasurisë vetting.
44. Kolegji konstaton se subjekti ka ndarë shprehimisht në deklarimet e tij shumën prej 18.000 eurosh, si një ndër burimet e krijimit të pasurisë dhe qartazi është shprehur për vlerën që ka pasuria në zotërim të tij. Përdorimi i kësaj shume si pjesë e padeklaruar e vlerës së objektit është shfaqur pas dërgimit nga Komisioni te subjekti i rivlerësimit i rezultateve të hetimit paraprak dhe, për këto arsye, vlerësohet nga Kolegji si argument që përpiqet të justifikojë pasaktësinë e deklarimit në një

<sup>7</sup> Në përgjigjet për rezultatet paraprake të hetimit, faqe {\*\*\*} e fashikullit dhe seanca dëgjimore faqe {\*\*\*} e fashikullit.

<sup>8</sup> Në paragrafin 2.25 të ankimit të subjektit të rivlerësimit.

kohë kur vlera e objektit, sipas përcaktimeve të Komisionit, kishte rezultuar në vlera shumë më të larta se ajo që kishte deklaruar ai si subjekt rivlerësimi. Për pasojë, në këtë këndvështrim, ky argument nuk shëron pasaktësinë në deklarim të subjektit, për sa i përket vlerës së pasurisë. Përkundër kësaj vlere të deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting*, por të mbështetur edhe nga deklaratimet në deklaratat periodike të viteve 2004 dhe 2009, konstatohen deklarime të ndryshme të vetë subjektit të rivlerësimit për sa i përket vlerës së godinës, në përgjigjen për rezultatet e hetimeve paraprake dhe në ankimin e paraqitur prej tij.

45. Gjithashtu, në këtë kontekst, Kolegji ka në konsideratë edhe faktin se qoftë vlera e përcaktuar prej Komisionit për këtë pasuri, qoftë ajo e supozuar si e mundshme prej Kolegjit<sup>9</sup>, pas marrjes në konsideratë të disa prej pretendimeve të subjektit rreth vlerës së përcaktuar sipas kostos mesatare të ndërtimit, qoftë ajo e përcaktuar prej ekspertëve të zgjedhur prej tij, është e ndryshme nga ajo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, madje edhe nga ajo e pretenduar nga subjekti në ankim.
  46. Në përfundim, Kolegji arrin në konkluzionin se me të drejtë Komisioni ka vlerësuar që subjekti ka kryer deklarim të rremë në lidhje me deklarimin e kësaj vlere, pasi nga analiza e mësipërme rezulton se të dhënat e pasqyruara në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk i përgjigjen së vërtetës, për sa i përket vlerës së objektit, duke plotësuar në këtë mënyrë situatën e cila duhet kualifikuar si deklarim i rremë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.<sup>10</sup>
  47. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioni padrejtësisht nuk ka konsideruar si të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit të ardhurat nga emigracioni dhe si burim për ndërtimin e shtëpisë kredinë në vlerën prej 18.000 eurosh, të marrë nga NBG-ja në vitin 2004, si edhe as të ardhurat e vëllait të tij nga emigracioni, por edhe nga puna në Policinë e Shtetit, si edhe të babait të tij, M.Rr., nga emigracioni, për pasojë ka konkluduar në mënyrë të gabuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë shtëpi banimi.
- Kolegji në verifikim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mbështetur në aktet e administruara, vlerëson se qëndrimi i Komisionit është në thelb i drejtë, pavarësisht se arsyeton në mënyrë të ndryshme e mbi baza të ndryshme të dhënash.
48. Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, Kolegji vëren se në lidhje me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, atij nuk i janë njohur si të tilla të ardhurat e deklaruara prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, si të fituara në emigracion, për të cilat ai ka paraqitur dokumentacion justifikues, vërtetim bankar, si edhe dokumentacion provues pasaportë dhe dokumentacion qëndrimi, të cilat i janë bashkëlidhur deklaratës. Sipas qëndrimit të mbajtur prej Komisionit: [...] *Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e të ardhurave nga puna me dokumentacion justifikues ligjor, pra që të ketë qenë në marrëdhënie pune, por ai me anë të provave që dërgoi, provoi vetëm që ka qenë në Greqi, duke pretenduar se ka punuar. Nga ana tjetër, ai provoi se kishte shumë prej 1.600.000 lekësh në bankë, pa vërtetuar me dokumentacion ligjor burimin e tyre. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se këto para vinin nga emigracioni.*
  49. Për të kundërshtuar këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë me ankimin dhe para gjyqimit akte dokumentare nëpërmjet të cilave ai kërkonte të provonte faktin e një punësimi të ligjshme në shtetin grek përgjatë periudhës korrik 1997 - tetor 1998 dhe të ardhurat e realizuara prej

<sup>9</sup> Shih paragrafin 38 të vendimit.

<sup>10</sup> ALUZINI për objektin banesë me 5 kate në rrugën “{\*\*\*}”, për efekt të përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, ka përlllogaritur investimin për të gjithë objektin në vlerën 21.051.419 lekë.

kësaj marrëdhënieje. Kolegji ka konstatuar se përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa akte<sup>11</sup> që provojnë qenien e tij në Greqi në kohën e pretenduar prej tij dhe përpiqen të provojnë të ardhurat e deklaruara prej tij në shumën prej 1.600.000 lekësh.

50. Pavarësisht këtyre dokumenteve justifikuese, Komisioni ka vlerësuar në përfundim se subjekti nuk arriti të provojë burimin e këtyre të ardhurave dhe as ligjshmërinë e tyre, duke konkluduar se këto të ardhura në shumën prej 2.800.000 lekësh, nuk duhet t'i konsiderohen atij si të ardhura të ligjshme për efekt të analizës financiare që lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së blerjes së truallit dhe ndërtimit në vitet 2003-2004 të dy kateve të para të banesës, të deklaruara nga subjekti.
51. Kolegji konstatoi, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit ligjor provues të paraqitur gjatë hetimit administrativ, se për sa u përket të ardhurave të deklaruara se janë fituar nga puna si emigrant në Greqi, subjekti i rivlerësimit arriti të provojë faktin e qëndrimit në Greqi, ndërsa për sa i përket faktit të punësimit atje në këtë periudhë, ndonëse duket se ky qëndrim ka shërbyer për të punuar dhe krijuar të ardhura, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, në kuptim të ligjit, marrëdhëniet e tij të punës dhe krijimin e gjithë të ardhurave të deklaruara prej tij në shumën prej 2.800.000 lekësh, si dhe ligjshmërinë e tyre, sipas përcaktimeve të Nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
52. Në drejtim të provimit të këtij fakti, Kolegji gjen si të vetmin dokument shkresor vërtetimin e datës 22.01.2016, i lëshuar nga "Raiffesien Bank" ShA, sipas të cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit kishte çelur një depozitë kursimi në ish-Bankën e Kursimeve më datë 23.10.1998, me nr. depozite {\*\*\*}, me afat tremujor, në shumën 1.600.000 (një milion gjashtëqind mijë) lekë. Për sa i përket shumës prej 1.200.000 lekësh, që subjekti pretendon se i ka mbajtur në shtëpi pas kthimit nga emigracioni, nuk rezulton të ketë asnjë gjurmë dokumentare, përveç deklarimit në deklaratën *vetting*. Subjekti nuk ka bërë deklaram për këto të ardhura apo transformimin e tyre në ndonjë pasuri në asnjë prej deklaratave periodike në vite. Për pasojë, Kolegji e gjen të pabazuar e të paprovuar pretendimin e tij se e gjithë shuma prej 2.800.000 lekësh duhet të llogaritet si e ardhur e tij prej emigracionit. Pavarësisht kësaj, duke qenë se depozitimi i shumës prej 1.600.000 lekësh në "Raiffesien Bank" rezulton të jetë kryer më datë 23.10.1998, ndërkohë që subjekti rezulton të jetë kthyer nga shteti grek më datë 12.10.1998, Kolegji në kushtet e refuzimit të marrjes së provave të reja të sjella prej subjektit të cilat kishin për qëllim të provonin këtë fakt, pa marrë qëndrim rreth provueshmërisë dhe ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, por në këndvështrim të pretendimeve të subjektit të parashtuara në ankim, vlerësoi që hipotetikusht t'ia nënshtrojë shumën e depozituar në bankë, bashkë me interesat e tërhequra prej saj, analizës financiare, duke i konsideruar ato si të ardhura të subjektit, për të kontrolluar se si kjo shumë mund të afektonte analizën financiare të subjektit.
53. Kolegji çmon se ky trajtim është tejet garantist në raport me të drejtat e subjektit e rivlerësimit dhe konsiderohet si i tillë në këndvështrim dhe për konsekuencë të refuzimit të marrjes së provave të reja, të cilat sipas subjektit do të provonin ekzistencën dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Kolegji vlerësoi ta përfshijë vetëm këtë shumë në një analizë hipotetike dhe jo të gjithë shumën e dekluarar si e ardhur nga emigracioni prej subjektit, në masën 2.800.000 lekë, duke qenë se duket që ka një lidhje të arsyeshme me punën e pretenduar në emigracion, për sa kohë përkon me kohën

---

<sup>11</sup> Leja e punës e lëshuar nga autoritetet policore greke; pasaporta e tij e vjetër, e lëshuar më datë 09.01.1998, ku pasqyrohet kthimi ose hyrja në Shqipëri nga shteti grek më datë 12.10.1998; vërtetimi i datës 22.01.2016, i lëshuar nga "Raiffesien Bank" sh.a., sipas të cilit vërtetohet se subjekti i rivlerësimit kishte çelur një depozitë kursimi në ish-Bankën e Kursimeve më datë 23.10.1998, me nr. depozite {\*\*\*}, me afat tremujor, në shumën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë, si dhe 1,2 milionë lekë që subjekti shpjegoi se i kishte mbajtur në shtëpi deri në vitin 2000, kur ishte blerë truall i banesës së tij.

e kthimit nga emigracioni dhe është fituar në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk kishte kryer asnjë punë tjetër, për shkak të qenies ende në proces edukimi. Kjo provë analitike çmohet të ushtrohet vetëm për shkak dhe konsekuencë të vendimit për refuzimin e marrjes së provave të reja, të cilat edhe sikur të merreshin e të kishin vlerë provuese do të arrinin të provonin vetëm se këto të ardhura janë krijuar nga punësimi në Greqi dhe në mënyrë të ligjshme. Për sa i përket diferencës prej 1.200.000 lekësh, të cilat subjekti pretendon se i ka fituar nga puna në emigracion por i ka mbajtur në shtëpi, Kolegji vlerësoi se nuk duhen konsideruar si të ardhura në analizën financiare, as në kontekst të arsytimit të mësipërm, për sa kohë që për ekzistencën e tyre nuk është paraqitur asnjë provë dhe nuk ka pasur asnjë deklaram të subjektit. Nëse këto para të fituara do të ishin në shtëpi, siç subjekti deklaroi, ato duhet të gjendeshin në një formë të shprehura në deklaratën fillestare të deklaramit të pasurisë së vitit 2003, në masën e mbetur pas financimit me këto të ardhura të blerjes së truallit, siç deklaroi në këtë deklaratë, aq më tepër kur subjekti ka pretenduar gjatë gjithë kohës se objekti banesë është ndërtuar pas kësaj periudhe edhe me të ardhurat e fituara në emigracion.

54. Përpjekja e subjektit (në seancë dëgjimore) që deklarimi si gjendje *cash*, në deklaratën e vitit 2003, i shumës “3 milionë lekë të vjetra”, për ta trajtuar këtë përcaktim si lapsus, duke qenë se bëhej fjalë për 3 milionë lekë të reja, është në vlerësimin e Kolegjit jobindëse dhe e pabazuar.
55. Në përgjigje të pretendimeve të subjektit, Kolegji vlerësoi gjithashtu të konsiderojë shumë prej 18.000 eurosh, të përfutur prej subjektit nga kredia e marrë në NBG Bank, në prill të vitit 2004, si të ardhur për vitin 2004 dhe si një burim i krijimit të pasurisë shtëpi banimi, për dy katet e para të deklaruara si të ndërtuara në vitet 2003-2004.
56. Në ndryshim nga arsytimi i përdorur prej Komisionit dhe duke pranuar si kohë të ndërtimit të shtëpisë periudhën e deklaruar prej subjektit, Kolegji vlerëson se shuma e marrë kredi duhet të konsiderohet si një burim për ndërtimin e shtëpisë. Përpos faktit se koha e marrjes së kredisë përkon me kohën e ndërtimit të dy kateve të para të shtëpisë, Kolegji në këtë vlerësim ka parasysh edhe faktin se kredia është deklaruar që në deklaratën periodike të vitit 2004, pa u deklaruar destinacioni i saj, destinacion i cili është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2008 si “ndërtim shtëpie”, deklarim ky që rezulton të jetë i njëjtë me atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke bërë të besueshëm këtë deklaram të fundit, referuar vlerës provuese që kanë deklaratat periodike të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Përpos këtij argumenti, Kolegji ka konsideruar gjithashtu edhe faktin se nga hetimi administrativ nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të tregojë se kjo shumë parash është përdorur në ndonjë destinacion tjetër, qoftë në drejtim të pasurive të paluajtshme apo të luajtshme. Destinacioni fillestar i kredisë, sipas kontratës bankare të marrjes së kredisë, ka qenë: *blerja e një apartamenti, me adresë rr. “{\*\*\*}”, Tiranë*, pa u specifikuar pasuria konkrete. Duket si një përshkrim i nevojshëm për të motivuar nevojën për marrjen e kredisë, por nuk rezulton ndonjë e dhënë që ky apartament të jetë blerë realisht prej subjektit të rivlerësimit.
57. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për sa i përket moskonsiderimit të të ardhurave të siguruara prej punës në emigracion të vëllait të tij, B.Rr., dhe të babait, M.Rr., Kolegji konstaton se gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se kati i parë i banesës është ndërtuar me kontributin e vëllait të tij, B.Rr., në vlerën 1.600.000 - 1.800.000 lekë dhe kati i fundit me kontributin e vëllait, përafërsisht në vlerën 900.000 - 1.000.000 lekë. Gjatë shpjegimeve të tij, ai ka deklaruar gjithashtu se edhe babai tij, M.Rr., ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë përafërsisht me 4-5 milionë lekë.

58. Në verifikim të këtyre shpjegimeve, Komisioni ka verifikuar mundësinë e vëllait të subjektit, z. B.Rr., për të financuar në vlerat e pretenduara prej subjektit të rivlerësimit në ndërtimin e katit të parë dhe të fundit të banesës. Subjekti ka paraqitur në funksion të provimit të këtyre pretendimeve, dokumentacion që sipas tij provon faktin e punësimit të vëllait të tij në Greqi dhe të ardhurat e realizuara prej kësaj marrëdhënieje<sup>12</sup>, si edhe vërtetime nga drejtoritë e policisë së qarqeve Shkodër dhe Tiranë për të provuar të ardhurat e tij gjatë kohës së punësimit në këtë institucion në vitet 2002-2004 dhe deri në vitin 2009, kohë që përkon me kohën e deklaruar se është ndërtuar banesa.
59. Komisioni nuk ka njohur dhe nuk ka llogaritur si të ardhura të ligjshme të ardhurat e pretenduara se janë krijuar nga puna e vëllait në emigracion, por edhe nga puna e tij si punonjës i Policisë së Shtetit në Shkodër, duke konsideruar si të pasaktë shkresën përkatëse të përcjellë prej këtij institucioni, në mungesë të elementeve të formës. Subjekti i rivlerësimit ka kontestuar këto konkluzione, duke mbështetur pretendimet e tij në dokumentacionin e sjellë nga Greqia dhe duke analizuar përmbajtjen e shkresës së Drejtorisë së Policisë Shkodër, si të saktë dhe të ligjshme.
60. Kolegji mori në shqyrtim këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, duke pranuar si fillim se vëllai i subjektit të rivlerësimit duhet të trajtohet si person tjetër i lidhur, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa i përket kontributit të tij financiar në ndërtimin e katit të parë dhe të fundit të banesës. Ky përcaktim merr rëndësi për shkak të statusit ligjor dhe regjimit të të drejtave pasurore që subjekti i rivlerësimit ka fituar me legalizimin e kësaj pasurie, duke qenë se i gjithë objekti është legalizuar dhe regjistruar si pasuri vetëm e subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, përfshirë edhe katet për të cilat subjekti pretendon se janë ndërtuar me financimin e vëllait të tij, B.Rr.. Në këtë kuptim, Kolegji e gjen të drejtë konsiderimin e vëllait të subjektit, z. B.Rr., si person tjetër i lidhur, për sa i përket këtij kontributi dhe, për pasojë, gjen të drejtë edhe konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të vlerës së deklaruar se ka shërbyer për ndërtimin e banesës.
61. Në analizë të dokumentacionit të dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit për të provuar sa më sipër, Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e mbajtur prej Komisionit në drejtim të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për të provuar realizimin e të ardhurave në shtetin grek, si të pamjaftueshëm dhe jo të plotë, në drejtim të provimit të faktit se të ardhurat e tij kanë qenë tilla që të mundësonin investimin e pretenduar në vitet 2003-2004 për ndërtimin e banesës. Kolegji gjithashtu vëren se nuk gjenden gjurmë të ekzistencës së këtyre parave, edhe të tilla si ato të

<sup>12</sup> Gjatë hetimit administrativ, subjekti në lidhje me të ardhurat e krijuara nga emigrimi prej vëllait të tij, z. B.Rr., ka paraqitur dokumentin kontratë private pune e B.Rr., e lidhur më datë 05.06.2001, në {\*\*\*} Greqi (me afat 6-mujor), në gjuhën greke, e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe.

Me ankimin për të provuar të ardhurat e krijuara nga vëllai i tij, B.Rr., në Greqi, subjekti ka paraqitur librezën e kursimit pranë Bankës Kombëtare Greke, me nr. llogarie {\*\*\*}, e vitit 1998, në emër të B.Rr..

Me shkresën e regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.03.2019, pas depozitimit të ankimit, subjekti ka paraqitur vërtetim pune për shtetasin B.Rr., i lëshuar nga Komuna {\*\*\*}, i datës 20.02.2019, ku thuhet se ky shtetas ka qenë i punësuar në ferman blegtorale të komunës dhe është strehuar pranë punëdhënësve. Vërtetimi shpreh se ky shtetas ka qenë i punësuar vazhdimisht për një periudhë 2- (dy-) vjeçare gjatë viteve 1999-2000 dhe 2001 me punë sezonale çdo 4-mujor gjatë verës, për 30 ditë çdo muaj, me pagë ditore që varionte rreth 5.000 drahmi në ditë, dokument i cili është i pajisur me vulë apostile, i përkthyer në shqip dhe i noterizuar.

Me shkresën tjetër të regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2019, pas depozitimit të ankimit, subjekti ka paraqitur: 1) vërtetim lëshuar nga Ministria e Punës, Sigurimeve Shoqërore e Mirëqenies Sociale, Organizimi i Punësimit të Fuqisë Punëtore, {\*\*\*} Greqi, datë 04.03.2019, nr. {\*\*\*}, për z. B.Rr. (dokumenti është në gjuhën greke, i pajisur me vulë apostile, i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën shqipe); 2) dokument i lëshuar nga regjistri i të siguruarve, dega {\*\*\*}, Greqi, datë 08.04.2019, me emërtimin "Vërtetim regjistrimi si i siguruar i drejtpërdrejtë" për z. B.Rr. (dokumenti është në gjuhën greke, i pajisur me vulë apostile, i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe).

paraqitura prej vetë subjektit të rivlerësimit, me depozitim në bankë të një shume të ardhur prej emigracionit. Edhe në provat e reja të paraqitura në Kolegj prej subjektit në këtë drejtim, e vetmja gjurmë që do të mund të konsiderohej relevante me çështjen lidhet me gjendjen e një shume prej përafërsisht 200.000 lekësh (e përfutur nga konvertimi i monedhës së kohës), e cila edhe po të konsiderohej hipotetikusht si e ardhur për vëllain e subjektit në një analizë financiare, konstatohet se është e pakonsiderueshme në drejtim të ndryshimit të konkluzionit të Komisionit për pamundësinë e provimit të burimit të ligjshëm për paratë e përdorura si burim i financimit të banesës. Për këto arsye, Kolegji çmoi se marrja dhe nënshtrimi i gjykimit për provat e reja të paraqitura prej subjektit, që do të provonin të ardhurat e vëllait të tij, z. B.Rr., të siguruara nga emigracioni, ishin të panevojshëm në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016. Sipas vlerësimit të Kolegjit, në çdo rast, edhe sikur këto prova të provonin faktin e punësimit dhe fitimin e të ardhurave, këto të ardhura nuk mund të ishin më shumë se kjo shumë e depozituar në bankë, dhe në këtë rast, edhe llogaritja e kësaj shume nuk do të ndikonte në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

62. Kolegji, në ndryshim nga Komisioni, gjen të drejtë pretendimin e subjektit se në të ardhurat e vëllait të tij duhet të ishin llogaritur të ardhurat e fituara nga puna në Policinë e Shtetit në Shkodër për periudhën gusht 2002 - janar 2005, pavarësisht formës së zgjedhur nga ky institucion për formulimin e dokumentit provues, për sa kohë që nuk kontestohet përmbajtja e këtij dokumenti dhe as vërtetësia e të dhënave të paraqitura në të, as edhe prej vetë Komisionit<sup>13</sup>.
63. Në lidhje me pretendimin për të njohur si burim për ndërtimin e shtëpisë objekt verifikimi kontributin financiar të dhënë prej babait të subjektit, z. M.Rr., në vlerën prej 400.000 -500.000 lekësh, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni nuk e ka përfshirë këtë kontribut në përlllogaritjen e burimeve financiare të përdorura për ndërtimin e shtëpisë. Pavarësisht faktit nëse babai i subjektit kishte ose jo mundësinë të krijonte në mënyrë të ligjshme këtë sasi të ardhurash, në vlerësimin e Kolegjit, fakti që subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar asnjëherë më parë këtë kontribut si një prej burimeve të ndërtimit të shtëpisë së tij, qoftë edhe vetëm për pjesën që ai pretendon se i takon, e bën të pabesueshëm deklarin e tij si burim vetëm pasi Komisioni i ka kaluar barrën e provës për pamundësinë e financimit me burimeve të ligjshme të kësaj pasurie. Objekt i verifikimit dhe kontrollit në këtë proces është edhe verifikimi i vërtetësisë së deklarimeve të subjektit, sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, për pasojë mungesa e deklarimit për këtë burim e nxjerr atë jashtë procesit të verifikimit, në kuptim të këtij procesi rivlerësimi.
64. Kolegji, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, ka kryer analizën financiare për të ardhurat e shpenzimet e subjekti të rivlerësimit, në funksion të verifikimit të mundësisë së tij dhe të personit tjetër të lidhur me të (vëllai B.Rr.) për të përballuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e pasurisë shtëpi banimi, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, duke përdorur në këtë analizë edhe konkluzionet e Kolegjit të renditura më lart, për sa i takon:
  - a) kohës së ndërtimit të objektit në vitet 2003-2004;
  - b) vlerës së objektit, prej 18143.052 lekësh, sipas referimit në koston mesatare të ndërtimit, përcaktuar prej EKB-së, por edhe në referim të kësaj kostoje, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë TVSH-së, fondit rezervë dhe fitimit sipas strukturës së përcaktuar për llogaritjen e kësaj kostoje;
  - c) burimeve të ligjshme të pranuar në këtë arsyetim se janë përdorur për ndërtimin e tij, sipas analizës më sipër.

---

<sup>13</sup> Komisioni ka përdorur të njëjtën shkresë për të konsideruar si të ardhura të vëllait ato të fituara përgjatë viteve 2005-2009, ndërsa nuk i ka njohur ato të fituara në vitet 2002-2005.

65. Referuar analizës financiare të kryer si më lart, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar ndërtimin e objektit në shumën 18.143.052 lekë, referuar kostos së ndërtimit sipas asaj të përcaktuar prej Entit Kombëtar të Banesave dhe në shumën prej 13.468.682 lekë, referuar kostos së reduktuar sipas përshkrimit të mësipërm.
66. Kolegji konstaton se në çfarëdo skenari favorizues e garantues për subjektin e rivlerësimit, në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës, si edhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit e objektivitetit, subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte sipas detyrimit kushtetues vlerën e saktë të kësaj pasurie mbi të cilën bazohet edhe llogaritja e mundësisë për ndërtimin e saj me burime të ligjshme. Kolegji ka parasysh se barra e provës për të provuar këtë vlerë është një detyrim i subjektit të rivlerësimit sipas nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe në kushtet kur ai dështoi të provonte këtë fakt, pavarësisht nga rrethanat, organet e rivlerësimit me të drejtë u referohen standardeve ligjore të njohura e të zbatuara për të realizuar verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Kolegji vëren se edhe nëse do të konsideroheshin si të ardhura të ligjshme të gjitha të ardhurat e pretenduara prej subjektit të rivlerësimit, përsëri ato nuk arrijnë të mbulojnë të gjithë vlerën e ndërtimit të këtij objekti dhe diferenca e pambuluar mbetet në çdo rast e rëndësishme dhe e patolerueshme edhe në kontekst të çdo gabimi apo vlerësimi subjektiv të ndonjë elementi.
67. Në lidhje me shkakun e ankimit i cili kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie për sa i përket mosdeklarimit të katit të katërt dhe të katit të pestë të objektit banesë, e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në deklaratat periodike të viteve 2012, 2013, 2014, 2015 e 2016, Kolegji pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit kundrejt qëndrimeve të mbajtura nga Komisioni dhe mbështetur në analizën e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit në lidhje me këtë çështje, arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar pjesërisht, për sa i përket katit të parë të banesës, ndërkohë që Kolegji gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e fshehjes së pasurisë sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 për sa i përket mosdeklarimit të të drejtave të pronësisë mbi katin e fundit të banesës si në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në deklaratat periodike për vitet 2012-2016.
68. Siç rezulton nga hetimi administrativ, objekti banesë i ndodhur në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, i përbërë prej 5 (pesë) katesh, është ndërtuar në mënyrë informale përgjatë viteve 2003-2004 (tri kate) dhe 2009 (dy kate). Subjekti i rivlerësimit ka aplikuar pranë ALUIZNI-t nëpërmjet formularit të aplikimit të datës 25.03.2005 për të legalizuar këtë pronë, e cila është deklaruar prej subjektit si e ndërtuar prej tij. Pasuria godinë banimi në rrugën “{\*\*\*}” Tiranë, është regjistruar si pasuri në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka sipas përcaktimeve të bëra në lejen e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 20.02.2012, të dhënë për godinë me 5 kate, në zonën kadastrale {\*\*\*}, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe parcele ndërtimore 263,3 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe ndërtimi 131,4 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe totale të ndërtimit (për banim) 734 m<sup>2</sup>, me 5 (pesë) kate mbi tokë.
- Pas lëshimit të lejes së legalizimit, kjo godinë me 5 (pesë) kate është regjistruar pranë ZRPP Tiranë me të dhënat si vijojnë.
- Kati përdhës është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 131,4 m<sup>2</sup>, datë 15.03.2012, në emër të Dritan Rreshkës.
  - Kati i parë është regjistruar me nr. regjistri hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}2, me sipërfaqe prej 166,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.
  - Kati i dytë është regjistruar me nr. regjistri hipotekor nr. {\*\*\*}, me datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}3, me sipërfaqe 166,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.

- Kati i tretë është regjistruar me nr. regjistri hipotekor nr. {\*\*\*}, me datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 166,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.
  - Kati i katërt është regjistruar me nr. regjistri hipotekor nr. {\*\*\*}, me datë 15.03.2012, me nr. pasurie {\*\*\*}, me sipërfaqe 110,9 m<sup>2</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.
69. Subjekti i rivlerësimit ka kaluar pronësinë mbi katin e parë të banesës te vëllai i tij, z. B.Rr., nëpërmjet kontratës së dhurimit me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 03.04.2012, të hartuar nga noterja publike M.Ll. Më pas subjekti i rivlerësimit ka kaluar pronësinë mbi katin e fundit të banesës (kati i katërt) te vëllai i tij, B.Rr., nëpërmjet kontratës së dhurimit të hartuar nga noterja publike M.Ll., me nr. {\*\*\*} rep. e nr. {\*\*\*} kol., datë 10.01.2017. Komisioni ka arritur në konkluzionin se fakti që e gjithë pasuria është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në vitin 2012 dhe nuk është deklaruar prej tij, për më tepër nuk është deklaruar prej tij pronësia mbi katin e parë e të fundit, kualifikon këtë sjellje si fshehje të pasurisë.
70. Subjekti gjatë hetimit administrativ, por edhe në ankim e në parashtrimet e paraqitura pranë Kolegjit, ka pretenduar se regjistrimi i pronës në emër të tij është një akt formal, por që nuk tregon pronësinë e tij mbi gjithë godinën. Ky veprim është kryer për të lehtësuar procesin e legalizimit meqenëse subjekti gëzonte të drejtën e pronësisë mbi truallin në të cilin ishte ndërtuar objekti dhe aplikimi në mënyrë të veçantë do e kishte begatuar pa shkak subjektin në shifrën prej 3,75 milionë lekësh dhe do kishte dëmtuar financat e shtetit po aq, për shkak të nevojës për kompensim që organet shtetërore do të duhej të bënin për të kompensuar subjektin për truallin që kishte zënë me ndërtim vëllai i tij<sup>14</sup>. Për sa i përket mosdeklarimit të legalizimit të gjithë objektit, subjekti ka pretenduar në ankim se *pronar bëhesh nëpërmjet aktit të pronësisë dhe jo nga leja e legalizimit*, duke referuar për arsyetim në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009<sup>15</sup>.
71. Për sa u përket dy kateve, të parë e të katërt (kati i fundit), sipas subjektit të rivlerësimit, ato janë ndërtuar e janë financuar prej vëllait të tij, z. B.Rr., i cili ka qenë jo vetëm pronari *de facto* i tyre, por edhe poseduesi real<sup>16</sup> i tyre. Pasi shqyrtoi çështjen në fjalë, Kolegji çmoi se nuk gjenden elemente të fshehjes së pasurisë së legalizuar, e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht kati përdhes, i dytë dhe i tretë i objektit, duke qenë se këto pasuri ishin deklaruar si pronë e tij që në vitet 2004 e 2009, në deklaratat periodike përkatëse. Në kuptim të ligjit nr. 9046, datë 10.04.2003, “Për deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, parashikohet detyrimi i subjekteve deklaruese të deklarojnë shtesat dhe pakësimet e pasurisë të ndodhura brenda një viti kalendarik, dhe legalizimi i kateve si më sipër nuk ka konsistuar në shtesa të pasurisë së paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ai i ka deklaruar këto pasuri që në momentin e krijimit të tyre. Legalizimi i këtyre pasurive dhe regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme ka formalizuar statusin ligjor të këtyre pasurive që në kuptim të një deklarimi sa më transparent e të plotë, duhej të deklarohesh nga subjekti i rivlerësimit, por mungesa e këtij deklarimi, megjithëse është një pasaktësi në deklarim, nuk mund të interpretohet si fshehje e pasurisë për sa kohë që marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me këto pasuri ishte e njohur nga organet përkatëse, nga ILDKPKI-ja e ALUIZNI.

<sup>14</sup> Në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, si edhe ligjit nr. 10239, datë 25.02.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”.

<sup>15</sup> Në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 1, datë 06.01.2009, është arsyetuar: “Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrin e pasurive të paluajtshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme të pavlefshme, por nuk i jep blerësit mundësinë e tjetërsimit të saj të të tretët [...]”.

<sup>16</sup> Referuar të dhënave mbi vendbanimin në certifikatën e martesës së vëllait të subjektit të rivlerësimit.



72. Kolegji vlerësoi në të njëjtën logjikë edhe mosdeklarimin në vitin 2012 të katin të parë të objektit, i cili rezultoi se është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 15.03.2012 dhe i është dhuruar vëllait të subjektit më datë 03.04.2012, i cili nuk konsiderohet se përmbush elementet e fshehjes së pasurisë, për sa kohë që në fund të vitit të deklarimit, subjekti i rivlerësimit nuk kishte të regjistruar në emër të tij këtë pasuri. Në këtë konkluzion, Kolegji mban parasysh edhe historikun e deklarimit të kësaj pasurie, faktin që vëllai i subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar si vendbanim të përcaktuar, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, në certifikatën e martesës si banesën e tij që në vitin 2007, kontratën e furnizimit me energji elektrike të administruar nga OShEE-ja me nr. {\*\*\*} në emër të vëllait të subjektit, z. B.Rr., e cila është lidhur më 07.02.2010 ndërmjet z. B.Rr. dhe OShEE-së për një banesë private, kati i parë, rruga “{\*\*\*}” Tiranë, kohën e shkurtër nga data e regjistrimit në ZRPP Tiranë deri në datën e dhurimit të kësaj prone (15.03.2012-03.04.2012). Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kjo rrethanë megjithëse përbën një pasaktësi në deklarim, nuk duhet të konsiderohet si fshehje e pasurisë, për sa kohë e gjithë dinamika e veprimeve në lidhje me të duket se e shpëpusin subjektin e rivlerësimit nga marrëdhënia e pronësisë me këtë objekt.
73. Kolegji vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për sa i përket mosdeklarimit të pronësisë mbi katin e fundit të objektit, pronësi e cila figuron e regjistruar në regjistrat e ZVRPP Tiranë në vitin 2012 dhe ka mbetur e tillë deri në datën 10.01.2017, ditë në të cilën subjekti i rivlerësimit ia ka dhuruar atë vëllait të tij, z. B.Rr. Kolegji çmon se edhe në versionin e pasjes së një të drejte formale të pronësisë mbi këtë pronë, siç pretendon subjekti, përsëri ai kishte detyrimin ta deklaronte atë në deklarimin periodik të vitit 2012, për sa kohë që në fund të këtij viti kjo pasuri rezultonte si pasuri e shtuar e tij dhe vazhdonte të figuronte përsëri e regjistruar në emër të tij, duke përbërë në këto rrethana, shtim të pasurisë së paluajtshme të subjektit, në kuptim të ligjit nr. 4049/2003 që duhej deklaruar në vitin përkatës. Kolegji vëren se ndryshe nga tri katet e tjera për të cilat subjekti kishte bërë deklarime në vitet 2004 e 2009, për katin e fundit nuk gjendet asnjë gjurmë në deklaratat e tij periodike. Kjo gjendje e mosdeklarimit të këtij kati vazhdon edhe në vitet në vazhdim dhe kjo pasuri nuk deklarohet as në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke qenë se subjekti ia ka dhuruar vëllait të tij pak kohë para përpilimit të deklaratës.
74. Pretendimet e subjektit se edhe kjo pronë ishte në të njëjtat kushte si kati i dytë i objektit, pasi ai i përkiste *de facto* vëllait, prandaj dhe nuk është deklaruar, nuk e zhvesh subjektin e rivlerësimit nga detyrimi që ka pasur për deklarime të vërteta, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, por edhe të vetë ligjit nr. 84/2016. Kolegji nuk mund të qëndrojë pa vënë re se veprimi i dhurimit të kësaj prone vetëm pak ditë para përpilimit të deklaratës *vetting* pas disa vitesh mosdeklarim të saj, plotëson kushtet për ta konsideruar mosdeklarimin e saj si fshehje të pasurisë, në kuptim të procesit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Pretendimet e subjektit për justifikimin e regjistrimit në emër të tij të të gjithë godinës dhe mosdeklarimit të legalizimit të saj, të mbështetura mbi arsyet e shmangies së një përfitimi të padrejtë si kompensim për truallin në pronësi të tij, konsiderohen jorelevante nga Kolegji, pasi Kodi Civil njehtë mënyra të tjera të kalimit mes palëve të të drejtave pasurore, siç është dhurimi, në këtë rast mbi truallin, të cilat nuk bien ndesh me procesin e rivlerësimit. Gjithashtu gjendet jorelevant edhe pretendimi se detyrimi për regjistrim lind në momentin e marrjes së aktit të pronësisë dhe jo lejes së legalizimit, në referim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 06.01.2009, duke qenë se vlerëson se për efekt të procesit të legalizimit, është pikërisht leja e legalizimit akti që realizon fitimin e pronësisë në kuptimin ligjor për objektet e ndërtuara në rrugë informale, si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë dhe, në kuptim të procesit të deklarimit e kontrollit të pasurive, ky moment përkon plotësisht me momentin kur pasuria duhej të deklarohet, veçanërisht kati i fundit i objektit.

75. Kolegji, në verifikim të pretendimeve të subjektit të parashtruara me parashtrimet para zhvillimit të gjyqimit në Kolegji, mori në konsideratë edhe pretendimin se dhurimi i katit të fundit është kryer me vonesë, sepse dhurimi i njëkohshëm i të dy kateve në vitin 2012 do të penalizonte financiarisht vëllain e subjektit të rivlerësimit me pagimin e taksave të regjistrimit të pronës dhe konstatoi se në vitin 2012 ka qenë në fuqi dhe është zbatuar edhe udhëzimi nr. 12, datë 18.05.2011, i ndryshuar, “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”<sup>17</sup>, e cila ka bërë të mundur që në atë periudhë të aplikoheshin taksat më ulëta të regjistrimit ndër vite, edhe më të ulëta se ato që zbatoheshin në vitin 2017 dhe që për më tepër, pas konsultimit me Njësinë e Shërbimit Ligjor, rezultuan modeste për t’u përballuar. Përfundimisht, për këtë shkak ankimi, Kolegji gjen të drejtë pjesërisht pretendimin e subjektit të rivlerësimit vetëm për katin e dytë të banesës dhe gjen të mbështetur në fakte e në ligj qëndrimin e mbajtur prej Komisionit për sa i përket fshehjes së katit të fundit të banesës.
76. Në lidhje me shkakun e ankimit, i cili konteston konkluzionet e Komisionit për sa i përket mungesës së burimeve financiare të ligjshme në vitin 2011, për të shlyer kredinë prej 18.000 eurosh, të marrë në NBG në vitin 2004, si edhe në lidhje me shkakun e ankimit që lidhet me kontestimin e konkluzionit të Komisionit që ka konsideruar se pasuria likuiditet, në vlerën 1.900.000 lekë, e gjendur në llogarinë bankare në BKT, nuk ka burime të ligjshme, Kolegji kreu një analizë të integruar të këtyre dy shkaqeve, duke qenë se qëndrimi në lidhje me to varet nga analiza që i bëhet transaksionit të kryer prej subjektit të rivlerësimit, që nis me marrjen e një kredie të butë dhe përfundon me shitjen e shtëpisë së financuar me këtë kredi. Brenda këtyre shkaqeve ankimore, subjekti ka kontestuar edhe qëndrime të tjera të Komisionit, të cilat do trajtohen përgjatë kësaj analize në mënyrë integrale.
77. Në lidhje me këtë çështje, Komisioni është shprehur se në vitin 2011 subjekti ka shlyer shumën prej 15.000 eurosh si detyrim nga kredia e marrë në vitin 2004 (pranë NBG Bank) dhe se nga analiza financiare e këtij viti ka rezultuar se ai ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën prej 550.095 lekësh, për ta shlyer këtë kredi. Kjo diferencë negative, e krijuar në këtë vit, vjen si pasojë e ngarkimit të këtij viti edhe me shpenzimin e shumës prej 1.250.000 lekësh, të paguar sipas Komisionit prej subjektit të rivlerësimit ndaj shtetasit H.R., si këst për blerjen e një shtëpie të ndodhur në {\*\*\*}.
78. Siç rezulton nga hetimi administrativ, në vitin 2011 subjekti të rivlerësimit, në zbatim të VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, i është akorduar një kredi lehtësuese në shumën prej 5.000.000 lekë. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka dhe shtetasi H.R. kanë lidhur kontratën e shitblerjes me rezervë nr. {\*\*\*}6 rep. e nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2011, për një apartament të ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, me sipërfaqe 97,8 m<sup>2</sup>, për një çmim prej 6.250.000 lekësh. Sipas kontratës, palët kanë deklaruar se me nënshkrimin e saj blerësi (subjekti i rivlerësimit) i ka shlyer shitësit (H.R.) shumën prej 1.250.000 lekësh, ndërsa diferenca prej 5.000.000 lekësh do të shlyhet nga blerësi me lëvrimin e kredisë nga BKT-ja deri në datën 07.12.2011 dhe se kjo pronë do të jetë e bllokuar deri në momentin e likuidimit të gjithë shumës. Kontrata e kredisë mes subjektit të rivlerësimit dhe BKT-së rezulton të jetë lidhur në datën 09.03.2012 dhe po këtë ditë është parashikuar të bëhet edhe disbursimi i saj, duke pasur si pikë fundore shitësin H.R. Me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 09.12.2016, rezulton që subjekti i rivlerësimit t’i ketë shitur apartamentin në {\*\*\*}, blerëses N.Xh. e cila figuron të jetë bashkëshortja e shtetasit

<sup>17</sup> Ky udhëzim parashikon që në vitin 2012 deri në përfundim të vitit 2013, rivlerësimi i pasurisë kryhej kundrejt pagesës prej 1% të çmimit të rivlerësimit dhe kostos së ndërtimit të pasurisë; ndërsa në vitin 2016 referuar ligjit nr. 81/2016, datë 25.07.2016 dhe udhëzimit nr. 19, datë 26.08.2016, rivlerësimi kryhej kundrejt pagesës prej 2% të saj.

R.B., bashkortak me shtetasin H.R. në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për një çmim prej 6900.000 lekësh. Në deklarata noteriale të hartuara prej subjektit të rivlerësimit përgjatë procedurës së marrjes së kredisë me kushte lehtësuese, por edhe nga dy ortakët e shoqërisë {\*\*\*}, rezultojnë të dhëna të paqarta në lidhje me faktin e shlyerjes ose jo të shumës prej 1.250.000 lekësh; herë ajo duket se është shlyer dhe herë se është marrë përsipër prej ortakëve për ta shlyer më vonë.

79. Nga verifikimi i dokumentacionit që tregon mënyrën e ekzekutimit të këtij transaksioni, rezultojnë të dhënat e mëposhtme.
- a. Në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *Kam lidhur kontratë sipërmarrjeje për blerje apartamenti. Vlera e kontratës 6.250.000 lekë. Nga kjo shumë nuk është bërë asnjë pagesë deri më 31.12.2011 dhe do të shlyhet me kredi në BKT (detajet për këtë kredi në formularin pasardhës, pasi disbursimi i shumës së kredisë është bërë në muajin mars 2012).*
  - b. Në deklaratën periodike të viti 2012, subjekti ka deklaruar: *Referuar kontratës së shitjes së pasurisë me rezervë, të deklaruar në vitin 2011 për blerje apartamenti banimi në shumën 6.250.000 lekë, sqaroj se nga kjo shumë janë shlyer pjesa prej 5.000.000 lekësh nga kredia e marrë në BKT dhe pjesa tjetër prej 1.250.000 lekësh është detyrim i firmës së ndërtimit.*
  - c. Në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti ka deklaruar: *Detyrim për blerjen e apartamentit në shumën 1.250.000 lekë.*
  - ç. Në deklaratën periodike të vitit 2014, subjekti ka deklaruar: *Detyrim për blerje apartamenti në shumën 550.000 lekë, pasi deri në dhjetor 2014 për këtë apartament është shlyer detyrimi me vlerë 700.000 lekë. Në lidhje me këtë deklaram, konstatohet se subjekti me urdhërshkrimin e datës 24.12.2014 ka kryer transfertë të vlerës prej 700.000 lekësh nga llogaria e tij në Credins Bank te llogaria e H.R. në NBG Bank, me përshkrimin: *Pagesë për kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep.**
  - d. Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *Detyrim në vlerën 500.000 lekë, shlyer gjatë vitit 2015, mbetet ende detyrimi prej 50.000 lekësh. Në lidhje me këtë deklaram, konstatohet se më datë 03.06.2015, me 2 (dy) mandat arkëtime, përkatësisht me vlerë 30.000 lekë dhe 470.000 lekë, subjekti ka kryer një depozitim në total prej 500.000 lekësh në llogarinë e H.R. në NBG Bank, me përshkrimin: *Kësti nga Dritan Rreshka, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep.**
  - dh. Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *Detyrimi për blerje apartamenti 0 lekë, shlyer gjatë vitit 2016, detyrimi prej 50.000 lekësh, pa shpjeguar në çfarë forme është kryer: me cash, transfertë apo mandat arkëtimi. Sipas shpjegimeve të subjektit, ka rezultuar se kjo pagesë është bërë në formën cash.*
80. Sipas përcaktimeve të kontratës së shitblerjes së apartamentit nga subjekti te shtetasja N.Xh., janë kryer transaksionet për shlyerjen e detyrimeve përkatëse. Transaksionet janë kryer nëpërmjet llogarisë së noteres publike A.M., pranë bankës BKT, nëpërmjet transaksionit të datës 22.11.2016, me vlerë 4.565.000 lekë, i cili ka shlyer principalin e kredisë lehtësuese dhe transaksionit të datës 21.11.2016, me vlerë 2.335.000 lekë, i cili është depozituar në llogarinë personale të subjektit të rivlerësimit në BKT. Në përfundim të këtij transaksioni, pas shlyerjes edhe të detyrimeve që lidhen me interesat dhe penalitetet që i takojnë shlyerjes totale të kredisë, në llogarinë personale të subjektit të rivlerësimit ka mbetur gjendja prej 1.900.000 lekësh të deklaruara prej tij si pasuri likuiditet në deklaratën e pasurisë *vetting*.
81. Në analizë të këtyre fakteve të përshkruara më lart, Kolegji analizoi së pari konkluzionin e Komisionit se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për të paguar shumën prej 15.000 eurosh për shlyerjen e detyrimit të kredisë së marrë në vitin 2004 nga NBG-ja, duke mbajtur së pari një qëndrim në lidhje me faktin e pretenduar nga subjekti se konkluzioni i Komisionit se ai ka

paguar të gjithë detyrimin prej 1.250.000 lekësh të shitësi H.R., sipas përcaktimit të kontratës në vitin 2011, është një qëndrim që nuk ka ardhur si pasojë e analizës së plotë të të gjitha fakteve të dala nga hetimi. Kolegji vë re se Komisioni e ka mbështetur konkluzionin e tij vetëm në parashikimin e gjendur në kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 10.10.2011, në të cilën thuhet se blerësi e ka shlyer këtë detyrim, ndërsa Kolegji për të arritur në një konkluzion në lidhje me këtë çështje, në përgjigje edhe të pretendimit të ngritur në ankim prej subjektit të rivlerësimit, mori në analizë edhe faktet e tjera që rezultojnë nga aktet e cituara më lart.

82. Në këtë kontekst, përveç faktit që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që në deklaratën periodike të vitit 2011 se nuk ka shlyer asnjë detyrim për sa i përket detyrimit që rezulton nga kontrata e shitblerjes, dhe ka deklaruar në vitet e mëpasshme se detyrimi prej 1.250.000 lekësh është shlyer sipas kësteve të përshkruara në deklaratat periodike, dokumentacioni bankar në mbështetje të këtyre deklarimeve tregon pikërisht pagesat e kryera siç deklarohen. Në vijim të kësaj analize, Kolegji kreu analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011, duke konsideruar mënyrën e pagimit me këste të detyrimit prej 1.250.000 lekësh, për sa kohë që provat tregojnë se kjo shumë faktikisht i ka kaluar shtetasit H.R., nëpërmjet pagesave bankare jo në vitin 2011, por në vitet më pas. Pas analizës së kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, pavarësisht pranimit të këtij fakti siç e pretendon subjekti i rivlerësimit, ai rezulton përsëri me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për një shumë prej 179.329 lekësh<sup>18</sup> përkundrejt shumës prej 550.095 lekësh që kishte konkluduar Komisioni, duke e bërë këtë shumë të pakonsiderueshme për t'u përdorur si një shkak shkarkimi.
83. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se pasuria likuiditet prej 1.900.000 lekësh, e gjendur në llogarinë rrjedhëse në emër të subjektit të rivlerësimit, pranë bankës BKT, është një pasuri e krijuar me burime të paligjshme, Kolegji, pasi shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili përmes shpjegimeve të tij u përpoq të justifikojë transaksionin e kryer për shitblerjen pasurisë apartament në {\*\*\*}, në përmbyllje të të cilit gjenerohet kjo shumë, arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit për këtë çështje është i drejtë.
84. Siç u shpjegua më lart, pasuria likuiditet prej 1.900.000 lekësh është krijuar në përmbyllje të transaksionit që fillon me marrjen e kredisë lehtësuese dhe më pas me blerjen e shitjen<sup>19</sup> e apartamentit në {\*\*\*}. Përtej deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike të viti 2012 (viti i blerjes së apartamentit) dhe vitit 2016 (viti i shitjes së tij), subjekti ka shpjeguar dhe përcjellë rrethana të reja përgjatë hetimeve paraprake në lidhje me këtë transaksion. Ai ka shpjeguar në përgjigje të pyetjeve të Komisionit se kontratat e shitblerjes së apartamentit në {\*\*\*}, në fakt nuk kanë manifestuar vullnetin e vërtetë të palëve, veçanërisht të subjektit të rivlerësimit, por kanë qenë një mekanizëm që do të garantonte ekzekutimin në një kohë tjetër të vullnetit real të palëve, i cili lidhej me shitjen prej shoqërisë {\*\*\*} ShPK të subjekti i një apartamenti që do të ndërtohej prej

---

<sup>18</sup> Diferenca prej 179.329 lekësh, e ndryshme nga vlera negative prej 550.095 lekësh, e dhënë në vendimin e Komisionit, rezulton e tillë për shkak të moskonsiderimit në analizën e Kolegjit të shumave: 1.250.000 lekë (si pagesë për këtë apartament), e kryer nga subjekti në vitet 2014, 2015 dhe 2016; 183.478 lekë që rezulton nga diferenca e gjendjeve të bankave dhe pakësimi i gjendjes së cash-it të deklaruar nga subjekti (ndryshimi i likuiditeteve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor), e ndryshme nga vlera e vendosur nga KPK-ja prej 1.213.468 lekësh; 546.480 lekë (vlera e ndryshme e shpenzimeve të jetesës prej 650.000 lekësh, të konsideruara nga KPK-ja).

<sup>19</sup> Në shkresën e datës 05.10.2011, ortakët e shoqërisë {\*\*\*} ShPK, H.R. dhe R.B., i drejtohen BKT-së, duke i shpjeguar se marrin përsipër bllokimin e titullit të pronësisë apartament në {\*\*\*}, me sip. 97,8 m<sup>2</sup> në favor të klientit Dritan Rreshka, duke bërë bllokimin e pasurisë në fjalë për llogarinë tonë deri në momentin e kalimit të shumës së kredisë nga ana e bankës në favor të ortakut H.R., si dhe të shlyerjes së pjesës së mbetur të kredisë nga klienti Dritan Rreshka. Në momentin që nga ana e firmës do të ndërtohet apartamenti në {\*\*\*}, ata marrin përsipër të realizojmë shkëmbimin me këtë apartament, pasi të marrin aprovimin e bankës dhe të bien dakord me klientin Dritan Rreshka për diferencat ose pagesat e mundshme që mund të kenë ngelur nga kontrata e shitblerjes me rezervë të pasurisë.

kësaj shoqërie në Komunën {\*\*\*}, dhe për të cilën kjo shoqëri ishte pajisur me lejen e ndërtimit, miratuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2011, të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Komunës {\*\*\*}.

85. Subjekti ka shpjeguar se qëllimi për të cilin është lidhur kontrata e blerjes së apartamentit në {\*\*\*}, ishte për të bërë të mundur aprovimin dhe disbursimin e kredisë lehtësuese, e cila nuk mund të jepej nëse ortakët e shoqërisë {\*\*\*} ShPK nuk ofroheshin si dorëzanës dhe hipotekues, në formë garancie për realizimin e kontratës së kredisë me BKT-në. Subjekti ka pretenduar se në kushtet kur shtëpia që ai dëshironte të blinte nuk ishte ndërtuar ende dhe për të ishte marrë vetëm leja e ndërtimit, ortakët e shoqërisë nuk pranuan të bëhen dorëzanës nëpërmjet ndonjë prone tjetër në pronësi të tyre, por ata ofruan mundësinë e shitjes subjektit të rivlerësimit së një apartamenti tjetër që ishte në pronësi vetëm të një prej ortakëve, H.R., pasuri e cila do të shërbente si garanci për marrjen e kredisë. Me ndërtimin e objektit në {\*\*\*}, kjo kontratë do t'i ndërpriste pasojat e veta ligjore dhe shoqëria {\*\*\*} ShPK do të shiste te subjekti i rivlerësimit apartamentin tjetër që do të ndërtohej, sipas vullnetit të këtij të fundit. Duke qenë se ky objekt në {\*\*\*} nuk u ndërtua, madje leja e ndërtimit e miratuar për ndërtimin e tij është vendosur të shtyhet në kohë<sup>20</sup>, subjekti vendosi të ndërpresë marrëdhënien e krijuar me shoqërinë {\*\*\*} ShPK dhe ortakun e saj, z. H.R., duke ia rishitur të njëjtin apartament bashkëshortes së ortakut tjetër të shoqërisë, znj. N.Xh. (bashkëshortja e z. R.B.), duke hequr dorë nga synimi për blerjen e shtëpisë në {\*\*\*} dhe duke kthyer dhe likuiduar krejtësisht kredinë lehtësuese në vitin 2016.
86. Të gjithë këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit, Komisioni e ka parë të lidhur me aplikimin e bërë prej tij për të përfutur padrejtësisht kredinë lehtësuese, përfitimi i së cilës ka sjellë një sërë veprimesh në mashtim të ligjit e në fiktivitet, të cilat janë konsideruar prej Komisionit si veprime juridike të pavlefshme e për pasojë kanë sjellë konkluzionin për paligjshmërinë e krijimit të pasurisë likuiditet prej 1900.000 lekësh, të gjendur në llogarinë rrjedhëse në BKT, në emër të subjektit të rivlerësimit.
87. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se i gjithë transaksioni është i ligjshëm, edhe kërkesa e tij për të përfutur prej kredisë me kushte lehtësuese është në përputhje me kërkesat e ligjit, pasi ai në momentin kur ka aplikuar për këtë kredi, nuk figuronte të kishte të regjistruar asnjë pasuri të paluajtshme në emër të tij dhe as të dispononte një shumë parash më të madhe se 5.000.000 lekë.<sup>21</sup>
88. Kolegji, në analizë të të gjitha rrethanave që lidhen me këtë situatë faktike e ligjore, konstaton së pari se subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për të përfutur një kredi me kushte lehtësuese, në zbatim të VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, në kushte kur ndonëse ai nuk zotëronte ende një titull pronësie mbi pasurinë shtëpi banimi të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, prona e trajtuar më lart kishte përfunduar tërësisht ndërtimin e këtij objekti prej 5 katesh, në të cilin 3 (tri) kate ishin deklaruar prej tij si të tijat dhe kishte aplikuar për legalizimin e tij pranë ALUIZNI-t. Pra, ndonëse nuk zotëronte pasuri të paluajtshme në kuptimin e çdo tagri të së drejtës së pronësisë, posedonte një sipërfaqe të konsiderueshme banimi, për të bërë të mundur jetesën e tij dhe të familjes në kushte optimale. Pretendimet e tij se ai nuk ishte i sigurt për fitimin e titullit të pronësisë dhe prezantimi i situatave konfliktuale në rrethin familjar nuk ç’bëjnë faktin e mësipërm. Në këto kushte, Kolegji çmon se edhe në kushtet kur subjekti do të arrinte të justifikohet se në kuptimin formal të kriterëve të parashikuara nga VKM-ja nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë

<sup>20</sup> Vendimi nr. {\*\*\*} i Bashkisë Tiranë, datë 18.08.2017.

<sup>21</sup> Kushtet dhe kriteret për marrjen e kredisë me kushte lehtësuese janë të përcaktuara në VKM-në nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, e ndryshuar (aktualisht e shfuqizuar).

dhe të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, ai nuk kishte kryer asnjë veprim me shkelje, mbetet e pajustificuar dhe e padrejtë në kuptimin etik, përpjekja e subjektit të rivlerësimit për të përfituar një kredi me kushte lehtësuese, e destinuar dhe e konceptuar si një ndihmë e suport që shteti e ofronte për funksionarët e tij në kushte të pamundësisë apo vështirësisë për të siguruar strehimin me burimet e tyre financiare. Kjo sjellje nga Kolegji shihet jo në përputhje me praktikën e mira të njohura gjerësisht dhe të gjithëpranuara të parimeve të Bangalores<sup>22</sup> mbi sjelljen e magistratit.

89. Në vijim të kësaj përpjekjeje, vjen si konsequencë edhe kryerja e disa veprimeve fiktive (ku palët nuk kanë për qëllim të sjellin pasojën juridike që shprehin se dëshirojnë), të cilat për më tepër janë fokusuar në ngritjen e një mekanizmi transaksionesh që të mundësojnë përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, ndonëse banesa, për të cilën ajo kredi ishte akorduar, nuk ekzistonte dhe madje duket se as nevoja imediate e vetë subjektit për strehim.
90. Në këtë kuptim, transaksionet e kryera për shitblerjen e apartamentit në {\*\*\*}, thjesht për të realizuar marrjen e kredisë dhe blerjen më pas të një shtëpie tjetër kur ajo të ndërtohej, duket se janë kryer në mashtrim të ligjit, si me të drejtë Komisioni ka konkluduar. Nëpërmjet kryerjes së këtyre transaksioneve, subjekti ka synuar pikërisht të përfitojë një kredi me kushte lehtësuese, në një kontekst ligjor jo krejt të qartë për nevojën reale të tij për strehim. Sigurisht që subjektet e rivlerësimit, si çdo shtetas tjetër i këtij vendi, kanë të drejtën e lirinë e tyre kontraktore në funksion të realizimit të qëllimeve të tyre, por kryerja e këtyre veprimeve për qëllime të përfitimit nga fondet shtetërore, të konceptuara për të shërbyer në një destinacion tjetër, indukon elementin paligjshmëri në këto veprime.
91. Për këto arsye, në kushtet kur Kolegji pa marrë rolin e një gjykate civile që konstaton pavlefshmëritë e veprimeve juridike në kontekst të zgjidhjes së pasojave të palëve, por në analizë të natyrës së ligjshme ose jo të transaksioneve të kryera, çmon se e gjithë veprimtaria për realizimin e këtyre veprimeve juridike ka elemente të paligjshme brenda saj, të cilët afektojnë legjitimitetin e pasurisë së krijuar në përmbyllje të këtij transaksioni, pavarësisht faktit nëse kjo është një pasuri e shtuar ose jo e subjektit, por që sigurisht është një pasuri në pronësi të tij, për pasojë objekt verifikimi për sa i përket ligjshmërisë në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
92. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të rremë pasi në deklaratën periodike të vitit 2011, në të cilën ai ka deklaruar kontratën e blerjes së apartamentit në {\*\*\*}, ka deklaruar si palë shitëse shoqërinë {\*\*\*} ShPK dhe jo ortakun H.R., Kolegji e gjen si një pasaktësi në plotësimin e kësaj deklarate, duke qenë se subjekti ka cituar saktë ekstremitetet e Kontratës, duke e bërë lehtësisht të identifikueshëm shitësin e pasurisë. Në këto rrethana, përveç se është vetëm një deklaram në deklaratën periodike, nuk gjendet asnjë gjurmë për qëllimin e dhënies së rrethanave të rreme, për pasojë Kolegji vlerëson se kjo pasaktësi e vetme nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi.
93. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se obligacionet e blera në tregun primar pranë BKT-së janë të financuara krejtësisht me burime të ligjshme dhe se Komisioni ka gabuar që nuk i

---

<sup>22</sup> *Parimet e Bangalores të vitit 2002 përcaktuan një sërë “vlerash”, ku përfshihej edhe integriteti, të cilit duhet t’i përmbahen të gjithë gjyqtarët. Këto parime theksojnë se gjyqtari duhet të sigurojë që sjellja e tij të jetë e paqortueshme nga këndvështrimi i një vëzhguesi të arsyeshëm dhe mënyra e sjelljes duhet të ripohojë besimin e njerëzve tek integriteti i gjyqësorit. Parimet e Bangalores për sjelljen gjyqësore, 2002: [http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial\\_group/Bangalore\\_principles.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf) – miratuar nga Kombet e Bashkuara me rezolutën 2006/23.*

ka përfshirë në burimet për blerjen e tyre të ardhurat e përfituara nga qiraja e katit përdhes të banesës së tij, Kolegji pasi analizoi aktet e administruara dhe situatën financiare të subjektit, konkludoi se ky pretendim i tij qëndron.

94. Rezulton se subjekti ka deklaruar blerje obligacionesh pranë BKT-së më datë 21.10.2015 dhe më datë 17.02.2016, me vlerë 7900.000 lekë dhe me burim krijimi nga të ardhurat:
- i) nga punësimi si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë;
  - ii) nga puna si ekspert, pedagog;
  - iii) nga qiraja; dhe
  - iv) nga interesa të mëparshme bankare.
95. Subjekti pretendon se ka fituar të ardhura nga qiratë në shumën 4800.000 lekë, të cilat i kanë shërbyer për blerjen e obligacioneve. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare nga të ardhura të ligjshme për blerjen e këtyre obligacioneve, për shkak se: *[...] nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga qiraja e katit përdhes, për shkak se nuk kishte paguar detyrimet tatimore të të ardhurave nga qiraja për vitet 2009, 2010 dhe 2012, respektivisht për shumën prej 2.000.000 lekësh. Nga arsyetimi që përdor Komisioni për të deklaruar se kanë munguar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, kuptohet që diferenca negative në të ardhurat e shpenzimet e deklaruara nga subjekti për vitet në të cilat ka bërë këto blerje, 2015 dhe 2016, rezulton për shkak se Komisioni nuk i ka njohur si të ardhura të ligjshme të ardhurat e tij të përfituara nga qiraja e ambienteve të katit përdhes në objektin banesë, për vitet 2009, 2010 dhe 2012, në shumën prej 2.000.000 lekësh, duke qenë se sipas hetimit ai nuk ka paguar detyrimet tatimore për këtë periudhë. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion duke u mbështetur në shkresën e ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.02.2018, sipas së cilës rezulton se subjekti nuk ka paguar tatim për vitet 2009, 2010 dhe 2012<sup>23</sup>.*
96. Nga aktet e administruara, konstatohet gjithashtu se është sjellë në cilësinë e provës prej subjektit shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 12.07.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë për DIVA. Drejtoria Rajonale Tiranë ka konfirmuar në këtë shkresë që, pas verifikimit të regjistrave të mbajtur jashtë sistemit informatik, llogaritë e tatimeve të tjera deri më 31.12.2014, dhe verifikimit të sistemit c@ts pas viteve 2014 nga “Deklarata personale vjetore e të ardhurave”, rezultoi se individi D. Rreshka ka kryer pagesat për tatimin mbi të ardhurat nga qiratë. Ky informacion lexohet edhe nën tabelën që gjendet në përmbajtjen e shkresës, sipas së cilës subjekti ka paguar tatimet për periudhën 2009-2012 nëpërmjet Postës Shqiptare dhe në vitet në vijim, 2013-2016, nëpërmjet deklaramit të të ardhurave personale dhe më pas shlyerjes së detyrimit përkatës<sup>24</sup>.
97. Kolegji vlerëson se Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar pa analizuar në detaje përmbajtjen dhe vërtetësinë e të dhënave të dy shkresave të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, të cilat në vlerësimin e Kolegjit më shumë se sa kundërshtojnë njëra-tjetrën për informacionin që lidhet me

<sup>23</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 22.02.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, konfirmon se nga verifikimi i të dhënave në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, si dhe nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite, rezulton që individi Dritan Rreshka nuk ka biznes të regjistruar në DRT Tiranë. Ky shtetas rezulton i regjistruar si individ privat për DIVA (Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave). Bashkëlidhur shkresës janë kopje të deklaratave të dorëzuara për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, në të cilat është plotësuar rubrika “Të ardhura bruto nga qiraja” dhe ka likuiduar tatimin mbi qiranë me këto deklaratave, për të cilat nuk ka depozituar kontratë qiraje. Rezulton se më datë 19.03.2012, është likuiduar tatimi mbi qiranë në shumën 80.000 lekë, pagesë e cila nuk ka të depozituar kontratën e qirasë dhe nuk ka të specifikuar për cilën kontratë apo ambient është bërë kjo pagesë.

<sup>24</sup> Ky informacion jepet nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën konfirmohet se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore që lidhen me të ardhurat nga qiratë për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, përpara vitit 2014, sipas përshkrimit të bërë në shkresën me nr. {\*\*\*} prot., të datës 12.07.2018 dhe për këto detyrime nuk ka pagesa të kryera në vitin 2018, pasi këto janë kryer vite më parë.

pagimin e detyrimeve tatimore për vitet 2009, 2010 e 2012, përmbajnë informacione të paplota, në rastin e shkresës ku është bazuar Komisioni, duke qenë se në atë nuk paraqiten të dhëna për periudhën në fjalë, ndërkohë që shkresa e dytë përmban informacion për këtë periudhë, si për pagimin e detyrimit, ashtu edhe për mënyrën e përdorur (nëpërmjet Postës Shqiptare). Në analizë të sistemeve të informacionit e mbajtjes së të dhënave që u referohen shkresat, vihet re se ato u referohen sistemeve të ndryshme, të cilat kanë qenë të furnizuara me të dhëna për subjektet tatimore në mënyra të ndryshme dhe me metodologji po të ndryshme.<sup>25</sup> Nisur nga përmbajtja dhe informacioni që jep shkresa e datës 12.07.2018 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, Kolegji vlerësoi të pranojë si të ligjshme të ardhurat e krijuara nga qiratë e ambienteve për vitet 2009, 2010 e 2011 në vlerën 2.000.000 lekë, për sa kohë që në këtë shkresë rezultoi se subjekti ka paguar në kohë reale detyrimet tatimore për këto të ardhura. Duke përdorur këtë informacion, Kolegji, i ndihmuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë, nga e cila rezultoi se ai mbulon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurisë obligacione pranë BKT-së, në vlerën 7.900.000 lekë.

98. Së bashku me këtë konkluzion Kolegji, duke konstatuar paraqitjen e dokumentacionit me të dhëna të ndryshme nga i njëjti institucion shtetëror, në përgjigjet që institucionet u japin organeve të rivlerësimit dhe atyre që u japin subjekteve të rivlerësimit, si një problematike e hasur edhe në raste të tjera, bazuar në përcaktimet e nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, orienton Komisionin që në raste të ngjashme të kryejë hetime më të thella për të arritur në zbulimin e së vërtetës, si edhe të evidentojë problematikën e hasur në rrugë institucionale, për të shmangur përsëritjen e këtyre situatave në të ardhmen.
99. Në lidhje me shkakun e ankimit që kundërshton trajtimin si persona të tjerë të lidhur vëllain dhe kumatën e subjektit, z. S.Rr. dhe znj. A.Rr., dhe konkluzionin që ata i kanë dhënë një borxh shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në vlerën prej 32.951.037 lekësh, të cilin nuk mundën ta justifikojnë ligjërisht, Kolegji pasi analizoi të gjitha rrethanat e çështjes dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm, e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për sa i përket konkluzionit se ata janë persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, por ndan qëndrim të ndryshëm me Komisionin për sa u përket kufijve të hetimit të pasurisë së tyre. Në këto kushte, të cilat do të shtjellohen në vijim, Kolegji nuk mori në shqyrtim situatën faktike që lidhet me borxhin e pretenduar të personave të tjerë të lidhur.
100. Në lidhje me këtë shkak ankimor, Kolegji, në analizë të vendimmarrjes së Komisionit për këtë çështje, konstaton se Komisioni ka konsideruar si persona të tjerë të lidhur vëllain e subjektit, S.Rr., dhe kumatën e tij, A.Rr. (bashkëshortja e vëllait B.Rr.), si persona të tjerë të lidhur të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të parashikimit të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, mbështetur në faktet se:*
- a. *subjekti i rivlerësimit, pas legalizimit të godinës 5-katëshe, i ka dhuruar vëllait të tij, z. B.Rr. (bashkëshortit të znj. A.Rr.), 2 apartamente, duke lënë të kuptohet se ai është bashkëpronar, pasi kishte kontribuar financiarisht në shumën prej 2.800.000 lekësh;*

<sup>25</sup> Sistemi c@ts është sistemi elektronik, i cili mbledh, përpunon dhe raporton informacion tatimor dhe doganor. Nëpërmjet këtij sistemi, tatimpaguesve u ofrohet marrja e aksesit dhe përdorimi i shërbimeve të sistemit elektronik tatimor. Informacioni në këtë sistem hidhet nga tatimpaguesit nëpërmjet deklaratimit elektronik, si në rastin e deklaratave individuale vjetore të të ardhurave të viteve 2013-2016 të subjektit të rivlerësimit D. Rreshka, pas plotësimit të kriterit ligjor të të ardhurave vjetore nga të gjitha burimet, në shumën totale më shumë se 2.000.000. Ndërsa sistemi tatimor manual përpunon të dhëna tatimore në bazë të dokumenteve fizike fiskale, faturave tatimore dhe dëftesave të pagesave të tatimpaguesve, të kontabilizuara pranë drejtorive tatimore rajonale respektive.



- b. *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e vitit 2010 se për ndërtimin e katit të 3-të dhe të 4-t, kanë kontribuar vëllezërit, pra B. dhe S.Rr., duke nënkuptuar se ata janë bashkëpronarë në këtë godinë 5-katëshe;*
- c. *subjekti i rivlerësimit ka përdorur disa herë makinën, e cila është në pronësi të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas deklarimeve të bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit.*
101. Në këto rrethana, Komisioni ka hetuar për të verifikuar nëse, duke qenë me cilësinë e ortakëve dhe administratorëve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, blerë prej tyre në janar të vitit 2013, kishin mundësi financiare t’i jepnin shoqërisë një borxh prej 32.951.037 lekësh, i cili ka rezultuar sipas pasqyrave financiare se u përket atyre. Sipas analizës së Komisionit, këta persona nuk kishin mundësi financiare të jepnin borxh këtë shumë parash, pasi shoqëria nuk kishte ndarë fitim për të mundësuar këtë veprim dhe, për pasojë, kjo rrethanë, e parë në këndvështrim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive – e ka ngarkuar subjektin me detyrimin për të justifikuar mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për dhënien e këtij borxhi shoqërisë, dhe përderisa subjekti dështoi ta bënte këtë, kjo rrethanë është konsideruar si një shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit.*
102. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, ka pretenduar se së pari vëllai dhe kunata e tij nuk janë persona të tjerë të lidhur sipas ligjit nr. 84/2016, pasi ai nuk ka me ata asnjë marrëdhënie dhurimi apo huaje, sipas përcaktimit të nenit 32, pika 4 e këtij ligji dhe, edhe sikur të konsideroheshin të tillë, borxhi i përcaktuar prej Komisionit nuk është një borxh i ortakëve ndaj shoqërisë, por një borxh i kreditorëve të tjerë të tretë ndaj shoqërisë, konkluzion i dalë sipas tij nga analiza e pasqyrave financiare të bilanceve të shoqërisë, por edhe nga konkluzionet e nxjerra prej kontrollit të ushtruar në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK prej Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan. Subjekti gjithashtu ka kërkuar prej Kolegjit të merret në cilësinë e provës së re, në lidhje me këtë çështje, një sërë dokumentacioni i nxjerrë prej organeve tatimore që, sipas tij, provon pretendimet e tij sa më sipër.
103. Kolegji shqyrtoi fillimisht statusin ligjor të shtetasve S. e A.Rr. në raport me procesin e rivlerësimit, nëse ata do të konsideroheshin persona të tjerë të lidhur për subjektin e rivlerësimit dhe se deri në çfarë kufijsh do të ekzistonte detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e pasurisë së tyre.
104. Në këto rrethana, vërehet se në lidhje me konsiderimin e S. dhe A.Rr. në cilësinë e personave tjetër të lidhur, përfshirja e tyre në këtë cilësi është bërë pasi rezultojë të dy si ortakë të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, e cila i ka dhënë në përdorim të vazhdueshëm, të shtrirë në kohë, subjektit të rivlerësimit automjetin tip “{\*\*\*}”, me targa {\*\*\*}, fakt ky i dalë nga deklaratimet e vetë subjektit në pyetësorët nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}.
105. Lidhur me konstatimin tjetër të vendimit ku thuhet se S.Rr. ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë 5-katëshe, duke nënkuptuar se ai është bashkëpronar, vërehet se Komisioni kontributin e S. Rr. te ndërtimi i banesës e lidh me deklarin periodik të subjektit të vitit 2009, ku deklaroi shtesë kati me vlerë 600.000 lekë dhe si burim të të ardhurave përmend katin e ndërtuar vetë me kontributin financiar personal dhe të familjes (vëllezërve). Në analizim të situatës faktike, referuar dokumenteve të administruara në dosje, nuk rezultoi që Komisioni të ketë konstatuar apo vetë subjekti me shpjegime të ketë deklaruar se vëllai, z. S.Rr., të ketë kontribuar për ndërtimin e shtëpisë së subjektit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Për pasojë, konkluzioni që nxjerr Komisioni se vetëm ky deklarin i vitit 2009 e bën vëllain e subjektit të rivlerësimit bashkëpronar në banesën e ndodhur në

rrugën “{\*\*\*}”, vlerësohet në kapërcim të përcaktimeve e parashikimeve që ka Kodi Civil mbi mënyrat e fitimit të të drejtave të bashkëpronësisë, e cila nuk mund të barazohet e derivojë në çdo rast nga kontributi që një person jep për fitimin e pronësisë mbi një send.

106. Në lidhje me konsiderimin e znj. A.Rr. në cilësinë e personit tjetër të lidhur, njëkohësisht edhe për faktin se ajo është bashkëshorte e vëllait tjetër të subjektit të rivlerësimit, z. B.Rr., të cilit subjekti i ka dhuruar 2 kate të shtëpisë 5-katëshe në rrugën “{\*\*\*}”, referuar akteve të administruara në fashikull, rezulton se subjekti Dritan Rreshka katin e parë dhe të katërt të banesës në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. nëpërmjet kontratave respektive t’ia ketë dhuruar vetëm vëllait të tij B.Rr. dhe kjo rrethanë, sipas parashikimeve të Kodit të Familjes, nuk e bën bashkëshorten e tij të ketë automatikisht të njëjtin status ligjor si ai i bashkëshortit të saj.
107. Fillimisht Kolegji vlerëson t’i nënshtrojë analizës së tij përmbajtjen e dy dispozitave ligjore që trajtojnë personat e tjerë të lidhur në ligjin nr. 84/2016, përkatësisht nenin 3, pika 14 dhe 32, pika 4, të cituara më lart. Në analizë të këtyre dispozitave, Kolegji çmon se përcaktimet e bëra në nenin 3, pika 14 janë referime që duhet të përdoren për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, por edhe për t’u përdorur nga institucionet për të përcaktuar e parandaluar gjendjen e konfliktit të interesit, jo vetëm për subjektet e rivlerësimit, por edhe për anëtarët e organeve të rivlerësimit, të përcaktuar shprehimisht në këtë paragraf, krahas legjislacionit të posaçëm që rregullon situatën e konfliktit të interesit për zyrtarët.
108. Në të njëjtën linjë me këtë arsytim shkon edhe analiza e rregullit të vendosur në shtojcën nr. 2, që shoqëron ligjin nr. 84/2016, sipas së cilës: *Persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Personat e tjerë të lidhur, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, mbartin detyrimin për deklarimin e pasurisë në Inspektoratin e Lartë, me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit të Pasurive të Paluajtshme.* Kjo dispozitë duket se qëndron në harmoni me parashikimet që bën neni 3, paragrafi 11 i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, sipas të cilit: *Person i lidhur me një zyrtar është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin.*
109. Në analizë të kësaj situate ligjore, Kolegji çmon se përcaktimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 shërbejnë për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në kontekst më të gjerë, si në funksion të deklarimit e verifikimit të çdo situate të mundshme të konfliktit të interesit, pjesë gjithashtu e detyrueshme për kontroll si nga ILDKPKI-ja (shih nenin 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016), ashtu edhe nga vetë organet e rivlerësimit, edhe në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Përfshirja e një individi të caktuar në rrethin e personave të tjerë të lidhur, sipas përcaktimit të nenit 3, pika 14 krijon për subjektin e rivlerësimit dy konsekuenca ligjore: së pari, të provojë se nuk ekziston ndonjë situatë e konfliktit të interesit me këta persona, në kuptim të parashikimeve të legjislacionit të posaçëm që rregullon këtë fushë (Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale) dhe së dyti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tyre, kur plotësohen kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky detyrim i subjektit të rivlerësimit rezulton i qartë, përcaktuar në rrethana të veçanta, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pra, në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të

ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

110. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur. Pavarësisht, ky arsytim në asnjë rast nuk duhet të pengojë organet e rivlerësimit që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive.
111. Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji konstaton se në të gjitha versionet e paraqitura, edhe sikur S. e A.Rr. të ishin persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit për shkak të kontributit që ata (për llogari të A., bashkëshorti i saj) kishin dhënë në ndërtimin e shtëpisë, në funksion të këtij kontributi do të duhej të trajtohej dhe detyrimi i subjektit në provimin e ligjshmërisë së burimeve financiare për të mundur këtë kontribut financiar. Vetë Komisioni, por edhe Kolegji ka bërë një analizë të tillë për sa i përket vëllait tjetër të subjektit të rivlerësimit, z. B.Rr., dhe ka rezultuar me mungesë e pamundësi të burimeve të ligjshme për të financuar kontributin e pretenduar në vitin 2009, por ky konkluzion nuk mund të shtrihet e të përthithë ngjarje apo pasuri që kanë ndodhur apo janë krijuar pas mbarimit të kësaj marrëdhënieje, siç është pronësia e kumatës së subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, e fituar në vitin 2013.
112. Gjithashtu, në lidhje me kontributin e vëllait S.Rr. në vitin 2009 për ndërtimin e shtëpisë, as subjekti, as Komisioni dhe asnjë akt shkresor i dokumentuar në dosje nuk përcjell ndonjë informacion për rolin e tij kontribuues, sasinë apo masën e kontributit, as është llogaritur ndonjëherë ky kontribut i tij në ndërtimin e shtëpisë. Vetëm deklarimi i bërë nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2009, se ai është ndihmuar nga vëllezërit në ndërtimin e katit të katërt, por pa u përcaktuar asnjë e dhënë tjetër, e bën të pamundur përcaktimin e statusit të z. S.Rr. si person tjetër i lidhur, për sa i përket këtij kontributi.
113. Në këto kushte, elementi i vetëm i cili lidh subjektin e rivlerësimit me shoqërinë ”{\*\*\*}” ShPK dhe ortakët e saj, S. e A.Rr., është fakti i deklaruar prej subjektit se si ortakë të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ata i kanë dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit automjetin tip “{\*\*\*}”, me targë {\*\*\*}, për ta përdorur brenda e jashtë vendit në mënyrë të vazhdueshme dhe pa afat, fakt ky i dalë nga deklaratimet e vetë subjektit në pyetësorët nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}. Në këto rrethana, duke konsideruar se kjo marrëdhënie ka elementet e një marrëdhënieje huaje për shkak të qëndrueshmërisë së saj, sipas parashikimit të nenit 901 të Kodit Civil, sipas të cilit huapërdorja përkufizohet si vijon: *Me kontratën e huapërdorjes, njëra palë (huadhënësi) i jep palës tjetër (huamarrësit), pa kundërshpërblim, një send të caktuar që ta përdorë përkohësisht dhe kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë.* Kur nuk është caktuar afat, me kërkesën e palës që ka dhënë sendin, hetimi i Komisionit dhe detyrimi i subjektit duhej të përqendrohej te pasuria, automjeti i sipërpërmendur, dhe te verifikimi i burimeve të ligjshme të shoqërisë për ta blerë atë.

Nga verifikimi i bilanceve të shoqërisë, Kolegji me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor nuk ka konstatuar pamundësi të shoqërisë {\*\*\*} ShPK për të fituar me burime të ligjshme pronësinë mbi automjetin tip “{\*\*\*}”, me targë {\*\*\*}, i cili i është dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit.

114. Në këto rrethana, Kolegji, pavarësisht disa rrethanave të paqarta të konstatuara në transaksionet që janë kryer për kalimin e pronësisë së kuotave tek ortakët e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, të cilat mund të sqaroheshin vetëm nëpërmjet një hetimi të thelluar, të legjitimuar nga ekzistenca e dyshimeve për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, i gjendur në kushtet e mungesës së këtyre dyshimeve, çmoi se verifikimi i mëtejshëm i tyre kapërcente kufijtë e objektit të procesit të rivlerësimit. Duke arsyetuar në këtë mënyrë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji e konsideroi të panevojshme të hetojë më tej edhe për natyrën e marrëdhënies së ortakëve me borxhin që ka shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ndaj të tretëve, për sa kohë që në kontekstin e përshkruar në paragrafët më sipër, faktik e ligjor, vlerësoi se subjekti nuk ka detyrim të provojë ligjshmërinë e çdo pasurie apo marrëdhënieje juridike që i përket vëllait e kumatës së tij, S. e A.Rr..
115. Në lidhje me shkakun tjetër të ankimit, i cili konteston trajtimin si person tjetër i lidhur të nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. Xh.Rr., dhe gjithashtu edhe konkluzionin se ajo nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar pasurinë likuiditet në masën prej 3885914 lekësh, Kolegji, pasi analizoi këtë pretendim në këndvështrim edhe të arsyetimit të përdorur më sipër për personat e tjerë të lidhur, S. e A.Rr., arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i drejtë.
116. Për këtë çështje rezulton se Komisioni ka konstatuar: *[...] Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të shumës prej 3885.914 lekësh, vendosur në depozitë pranë “Raiffeisen Bank” nga ana e personit tjetër të lidhur, nënës së subjektit, znj. Xh. Rr, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.* Në lidhje me shtetasen Xh.Rr., nëna e subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se Komisioni nuk përmend/citon asnjë rrethanë faktike përse kjo shtetase, përtej faktit që është nëna e subjektit të rivlerësimit, gëzon statusin e personit tjetër të lidhur me subjektin. Në analizë edhe të të dhënave apo fakteve të dala nga hetimi e të verifikuara prej Kolegjit në funksion të shqyrtimit të ankimit të subjektit të rivlerësimit, nuk konstatohet asnjë rrethanë faktike (dhurim, huamarrje apo huapërdorje, apo kontribut financiar) si ato të parashikuara nga neni 3, pika 14 apo neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që do e kualifikonte nënën e subjekti të rivlerësimit si person tjetër të lidhur me të, për pasuritë e së cilës subjekti i rivlerësimit do të kishte detyrimin të provonte ligjshmërinë e burimit të krijimit. Edhe në këndvështrim të rrethanës së pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit se babai tij, z. M.Rr., ka kontribuar në ndërtimin e banesës në rrugën “{\*\*\*}”, në një vlerë prej 400.000 - 500.000 lekësh, Kolegji nënvizon faktin se ky pretendim nuk është konsideruar asnjëherë prej Komisionit dhe as prej vetë Kolegjit në analizën financiare të kryer për të parë mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të ndërtuar banesën, madje vetë Komisioni as e përmend si shkak të konsiderimit të nënës si person të tjetër të lidhur këtë element.
117. Në këto rrethana, duke konstatuar gjithashtu se nuk rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit të dhëna apo dyshime që kjo pasuri e depozitë në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit është një pasuri e fshehur e tij, situatë e cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, duke përdorur arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se nëna e subjektit të rivlerësimit është trajtuar si person tjetër i lidhur jo në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, për pasojë, detyrimi që Komisioni i ngarkon subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e depozitës në emër të saj është një detyrim në tejkallim të parashikimeve ligjore dhe nuk mund të shërbejë kjo rrethanë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

## II. Shkaqe që lidhen me procesin e rregullt

118. Në lidhje me pretendimin e subjektit se përfundimi i procesit të tij të rivlerësimit bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, është një vendimmarrje e paragjykuar dhe paracaktuar, Kolegji arsyeton se fakti që neni 59 i ligjit nr. 84/2016 me qëllim konfirmimin në detyrë kërkon domosdoshmërisht vlerësimin pozitiv të 3 (tri) kriterëve së bashku, nuk e ndalon Komisionin që në rastet kur konstaton se subjektet për një apo dy kriterë nga hetime të kryera rezultojnë se nuk kanë një nivel të besueshëm, të përfundojë rivlerësimin për ta. Kjo gjithashtu është edhe në funksion të moszvarritjes së procesit të rivlerësimit me rivlerësime për kriterë që edhe nëse rezultojnë me nivel kualifikues (kjo referuar vlerësimin profesional atij të figurës) nuk ndryshojnë në tërësi rezultatin mbi procesin e rivlerësimit të subjektit, por përkundrazi e zvarrisin atë<sup>26</sup>.
119. Lidhur me pretendimin e subjektit se dhënia e masës disiplinore për shkarkimin e tij nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 kërkon në mënyrë kumulative edhe bashkekzistencën e papërshtatshmërisë në lidhje me kriterin e pastërtisë së figurës dhe të pamjaftueshmërisë së pasurisë, sjell në vëmendje qëndrimin tashmë të mbajtur nga Kolegji në vendimet e tij lidhur me këtë parashtrim dhe konkretisht në vendimin nr. 10, datë 19.11.2018, ku në paragrafin 65 përcaktohet: *Lidhur me pretendimin e ankuesit se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas parashikimeve të këtij neni, subjekti i rivlerësimit mund të shkarkohet nëse plotësohen në mënyrë kumulative dy kriterë, pamjaftueshmëri në kontrollin e figurës dhe në atë të pasurisë, trupi gjyqës vlerëson se nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra.*
- Neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”, ndërkohë që neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Duke interpretuar dispozitat e mësipërme në mënyrë sistematike, Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret, dhe bazuar në nenin D, pika 5 të Aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarinimit të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive. Gjithashtu, edhe neni Dh i Aneksit të Kushtetutës bën një rregullim të kriterit të figurës, të posaçëm dhe të pavarur nga kriteri i pasurisë, dhe në të cilin parashikohet shkarkimi nga detyra qoftë edhe vetëm për pamjaftueshmëri të figurës.*
- Për sa më sipër, Kolegji këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit e konsideron të pabazuar në ligj.
120. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosdhënien e vlerës provuese raportit të ILDKPKI-së pasi ai është hartuar nga persona në konflikt të hapur interesi për shkak të

---

<sup>26</sup> Tashmë ky është një qëndrimi i konsoliduar i Kolegjit, të cilin e ka mbajtur në arsyetimin e shumë vendimeve të tjera, si vendimi nr. 11 (JR), datë 22.11.2018; nr. 3 (JR), datë 07.02.2019 etj.

mosmarrëveshjeve që kanë lindur përgjatë ushtrimit prej subjekti të rivlerësimit të funksioneve të prokurorit, Kolegji arsyeton se edhe sikur pretendimet e subjektit të rivlerësimit rreth konfliktit të ish-in të vërteta, konkluzionet e Komisionit mbi verifikimin e kontrollin e pasurisë së tij nuk janë mbështetur vetëm në raportin e hartuar nga Inspektorati, por në një hetim të thelluar të kryer nga vetë Komisioni. Në vendimin e Komisionit për subjektin e rivlerësimit nr. 55, datë 31.07.2018, lidhur me hetimin e kryer për kontrollin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit thuhet se:

*Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi (i) në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mundësisë së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Te ky paragraf, por edhe në tërësinë e arsyetimit të vendimit, trupi gjykues i Komisionit ka shprehur në mënyrë të qartë se konkluzionet e nxjerra prej tij nuk janë marrë nga raporti i ILDKPKI-së por janë produkt i hetimit të thelluar të kryer vetë prej tij.*

121. Ky qëndrim i Komisionit për të kryer një hetim të thelluar dhe të pavarur nga rezultati i raportit të ILDKPKI-së në rastin konkret, është dhe detyrim që rrjedh nga zbatimi i vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese ku thuhet se: *Në lidhje me procesin e kontrollit të pasurisë, parashikimi në nenin 33/1 të ligjit [nr. 84/2016] është në përputhje me parashikimin e pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pretendimi se termi “kontroll” që përdor Kushtetuta është për kontroll sipërfaqësor prima facie, është interpretim abuziv i normës kushtetuese. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dashur ta kufizonte kontrollin vetëm në mënyrë sipërfaqësore, do ta kishte bërë atë shprehimisht. Ligji në asnjë rast nuk mbron të drejtën dhe kompetencën e organeve të rivlerësimit për të kryer vetë verifikime, çka mund ta bëjnë kryesisht ose nëse krijojnë bindjen se hetimi i ILDKPKI-së nuk ka qenë i plotë dhe i saktë. Kushtetuta e ka bërë të qartë se marrëdhënia mes ILDKPKI-së dhe KPK-së është një marrëdhënie bashkëpunimi, për shkak se ILDKPKI-ja është një organ i specializuar dhe puna e saj e finalizuar me një raport ndihmon punën e organeve të rivlerësimit. Procedura e parashikuar nga Kushtetuta dhe nga ligji jo vetëm nuk cenon të drejtën për një proces të rregullt, por krijon mundësi për një proces të rregullt dhe efektiv, ku organi i specializuar i monitorimit ose i kontrollit jep një raport që vlerësohet në mënyrë të ndarë nga një organ administrativo-gjyqësor, sikurse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe një organ gjyqësor, sikurse Kolegji i Posaçëm i Apelit.*
122. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka, Kolegji pasi ka shqyrtuar të gjitha shkaqet e ankimit të parashtruara më sipër e të konsideruara relevante për zgjidhjen e çështjes, arrin në konkluzionin se edhe sikur të konsideroheshin të drejta të gjitha pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit, nuk do të cenonin qëndrimet e Kolegjit të mbajtura në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, qëndrime të cilat në mënyrë të pashmangshme plotësojnë kushtet e shkeljes së ligjit, të cilat përcaktojnë si sanksion shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.
123. Kolegji e mbështet këtë konkluzion në përfundimet e mëposhtme, sipas të cilave vendimi nr. 55, datë 31.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë në disponimin e tij për sa vijon:

1. Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë apartament ndodhur në katin e fundit të banesës në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, nëpërmjet mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike të viteve 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasuri e cila referuar të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, ka qenë e regjistruar si pronë në emër të subjektit të rivlerësimit të paktën që nga data 15.03.2012. Në këto kushte, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se ai gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
  2. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me koston/vlerën e pasurisë së tij, shtëpi banimi, e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Ai ka deklaruar përgjatë procedurës administrative në Komision se kostot e ndërtimit të banesës për pjesën që ai disponon janë në total 5.300.000 lekë, ndërsa referuar deklarimeve periodike të pasurisë dhe deklaratës së pasurisë *vetting*, të bëra nga subjekti i rivlerësimit, kjo vlerë është deklaruar në total 3.100.000 lekë, ndërkohë që nga hetimi administrativ në Komision, por edhe qëndrimi i mbajtur në Kolegj, kjo vlerë rezulton në çfarëdo rasti të jetë jo vetëm e ndryshme, por edhe më e lartë se këto deklarime të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se ai gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.
  3. Subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme krijimin e pasurisë shtëpi banimi, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në secilën prej periudhave të deklaruara prej tij se është realizuar ndërtimi i kësaj pasurie. Në këtë konkluzion, trupi gjykues arrin edhe sikur të konsideronte të vërteta disa prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të kostos së ndërtimit të objektit, edhe të ardhurave të ligjshme të përdorura për ndërtimin e saj. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi për të justifikuar me burime të ligjshme të ardhurat e përdorura për të përballuar shpenzimet për jetesë dhe ndërtimin e banesës, në të dyja periudhat kohore të pretenduara prej tij. Në këto kushte, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni ka konkluduar që subjekti gjendet në situatën e parashikuar prej nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
  4. Subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme pasurinë likuiditet prej 1.900.000 lekësh, të gjendur në llogarinë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit dështoi të provonte se veprimet juridike të kryera dhe që kanë pasur si pasojë krijimin e kësaj pasurie, janë realizuar në përputhje me ligjin e qëllimin e tij, për pasojë krijimi i kësaj pasurie nuk mbështetet në të ardhura të krijuara në mënyrë të ligjshme. Në këto kushte, Kolegji çmon se edhe në këtë rast, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në situatën e parashikuar prej nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
124. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shkaqet e tjera të ankimit të subjektit të rivlerësimit, arriti në konkluzionin se ato nuk gjenden të mjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
  125. Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe që janë pjesë e fashikullit gjyqësor, si dhe shqyrtoi vendimin nr. 55, datë 31.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Dritan Rreshka ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr.84/2016.

Në këto rrethana, Kolegji, pasi e gjykoi çështjen në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet 49 e 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, çmon se vendimi nr. 55, datë 31.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me vlerësimin e kriterit të kontrollit të pasurisë dhe masën disiplinore të vendosur, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pika 3 dhe në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 55, datë 31.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 17.07.2019.

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*